



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet
Kosova/Kosovo Prosecutorial Council



RAPORTI ANALITIK DHE KRAHASIMOR

PËR VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE
TË MEKANIZMIT PËRCJELLËS NDËRINSTITUCIONAL
PËR PERIUdhËN KOHORE: 2013-2021

KPK@2022

Autor: Besim Kusari,

Kordinator nacional për Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional.

Prishtinë, tetor 2022

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË: TRENDET

1	Mënyra e regjistrimit të rasteve penale karakteristike të MPN-së.....	10
1.1	Rastet penale të parashtruara nga subjektet.....	11
1.2	Mënyra e regjistrimit të rasteve penale karakteristike.....	12
2	Rastet penale të regjistruara në regjistrin 'PP'.....	13
2.1	Subjektet parashtruese.....	14
2.2	Procedimi i rasteve penale sipas llojit të veprave penale.....	15
2.3	Procedimi i rasteve penale sipas prokurorive.....	16
2.4	Ngarkesa me lëndë sipas llojit të veprave penale.....	17
2.5	Ngarkesa me lëndë sipas prokurorive.....	18
2.6	Procedimi i personave sipas llojit të veprave penale.....	19
2.7	Procedimi i personave sipas prokurorive.....	20
2.8	Ngarkesa me persona sipas llojit të veprave penale.....	21
2.9	Ngarkesa me persona sipas prokurorive.....	22
2.10	Vendimet dhe veprimet e prokurorive.....	23
2.11	Mënyra e procedimit të personave.....	24
2.12	Vendimet e gjykatës.....	25
2.13	Ankimimi.....	26
3	Rastet penale të regjistruara në regjistrin 'PPN'.....	27
3.1	Subjektet parashtruese.....	28
3.2	Mbyllja e rasteve penale.....	29
3.3	Ngarkesa me raste penale.....	30
3.4	Mbyllja e rasteve për persona.....	31
3.5	Ngarkesa me persona.....	32
3.6	Ngarkesa më, 31.12.2021.....	33

PJESA E DYTË: ANALIZA

4	Aspekte krahasimore.....	34
4.1	Raporti në mes aktakuzave dhe hudhjeve/pushimeve, sipas prokurorive.....	35
4.2	Raporti në mes aktakuzave dhe hudhjeve/pushimeve, sipas veprave penale.....	36
4.3	Niveli i akuzave të ngritura sipas veprave penale.....	37
4.4	Niveli i akuzave të ngritura sipas prokurorive.....	38
4.4.1	Prokuroria Speciale.....	39
4.4.2	Prokuroria Themelore në Prishtinë.....	40
4.4.3	Prokuroria Themelore në Prizren.....	41
4.4.4	Prokuroria Themelore në Pejë.....	42
4.4.5	Prokuroria Themelore në Gjiilan.....	43
4.4.6	Prokuroria Themelore në Mitrovicë.....	44
4.4.7	Prokuroria Themelore në Ferizaj.....	45
4.4.8	Prokuroria Themelore në Gjakovë.....	46
4.5	Trendi i regjistrimit të rasteve penale në regjistrin PPN.....	47
4.6	Kronologjia e regjistrimit të rasteve penale sipas regjistrave PP/PPN.....	48
4.7	Regjistrimi i rasteve penale sipas regjistrave në PSRK.....	49
4.7.1	Korrupsioni.....	49
4.7.2	Shpërlarja e parasë.....	50
4.8	Regjistrimi i rasteve penale të Korrupsionit në PTh.Prishtinë.....	51
4.9	Regjistrimi i rasteve penale sipas regjistrave në PTh.Pejë.....	54
4.9.1	Korrupsioni.....	54
4.9.2	Krimet ekonomike.....	55
5	Përfundimet.....	56
5.1	Konstatime.....	56
5.2	Rekomandime.....	62
5.3	Shtojcat.....	70

PARANTEZË

Këshilli Prokurorial i Kosovës në kuadër të realizimit të obligimeve dhe detyrave të parashikuara në Planin strategjik 2013-2015, dhe partnerët ndërkombëtare në kuadër të proceseve integruese të Bashkimit Evropian, me datë 10-11 maj 2013, kishte organizuar një takim pune (i njohur si takimi Prevallës),¹ me qëllim të krijimit të një mekanizmi përcjellës ndërinstitucional për zbulimin, hetimin, ndjekjen, gjykimin dhe ndëshkimin e kryesve të veprave penale karakteristike.

Në këtë takim janë përcaktuar veprat penale të cilat do të përbëjnë mekanizmin përcjellës si dhe veprimet procedural të cilat do të regjistrohen në bazën e të dhënave të krijuar enkas nga Këshilli Prokurorial i Kosovës me forca vetanake. Mekanizmin përcjellës e kanë përbërë këto grupe të veprave penale: Armët, Drogat, Kontrabanda me migrantë, krimi organizuar, korrupsioni, shpërlarja e parasë, trafikimi me qenie njerëzore dhe fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave, në vitin 2014 është përfshirë grupi i veprave penale të krimeve ekonomike ndërsa në vitin 2015, është përfshirë edhe vepra penale e nxitjes së urrejtjes.

Pas regjistrimit të informatave KPK-ja ka harmonizuar të gjitha të dhënat me subjektet parashtruese të kallëzimeve penale dhe me gjykatat, dhe si produkt i të dhënave të harmonizuara në fund të vitit 2013 KPK-ja ka hartuar, miratuar dhe publikuar raportin e parë të mekanizmit përcjellës i cili ka përfshirë periudhën kohore nëntë (9) mujore (01 janar deri 30 shtator 2013). Të dhënat e gjeneruara në raportin nëntëmujor të mekanizmit përcjellës kanë pasqyruar përqindje të lartë të pjesëmarrjes (mbi 50%) të veprave penale të korrupsionit nga numri i përgjithshëm i të gjitha veprave penale karakteristike.

KPK-ja në reflektim të kësaj përqindje të lartë të pjesëmarrje së veprave penale të korrupsionit ka hartuar dhe miratuar "Planin strategjik dhe planin e veprimit" për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e korrupsionit². Për më tej KPK-ja, në bazë të rezultateve të pasqyruara në mekanizmin përcjellës lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimit e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi nr.231/2014³ me institucione përkatëse si dhe ka miratuar rregulloren nr.1511/2013 themelimin dhe funksionalizimin e koordinatorit kombëtar për luftimin e krimit ekonomike duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale⁴.

Për më tej, në pajtim me këtë plan strategjik KPK-ja në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka themeluar "Njësitë"⁵ i posaçëm për zbatimin e këtij plani strategjik: trajtimi i kallëzimeve penale dhe Informatave PPN të këtyre dy grupeve të veprave penale karakteristike, duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Në bazë të të dhënave të gjeneruara nga Mekanizmi përcjellës ndërinstitucional, KPK-ja, ka filluar të hartojë edhe raporte mbi gjeografinë e Krimit, në të cilën pasqyrohet e shtrirjes së veprave penale karakteristike në hapësirën territoriale të Republikës së Kosovës, e cila shërben për hartimin e politikave kadrovike në profilizimin e prokurorëve dhe planifikimin strategjik për luftimin e kriminalitetit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës që nga viti 2014, ka hartuar dhe miratuar raporte analike dhe krahasimore, si ky raport, në të cilin pasqyrohen trendet lidhur me parashtrimin e kallëzimeve penale, mënyrën e procedimit të rasteve, vendimet e gjykatës, ankesat e prokurorëve etj. Theksojmë se në bazë të objektit të analizës nxirren konstatime dhe ofrohen rekomandimet për ngritjen e performancës së prokurorëve të cilat determinojnë besimit të publikut në sistemin prokurorial.

¹ [Institucionet dhe subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor.](#)

² Shif: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1285.2013-Plani_i_Veprimit_per_Rritjen_e_Efikasitetit_te_Sistemit_Prokurorial.pdf

³ Shif: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.231.2014_-_Memorandum_Bashkepunimi_fin.pdf

⁴ Shif: http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1511.2013-Rregullore_per_themelimin_dhe_funksionalizimin_e_Koordinatorit_Kombetare.pdf

⁵ http://www.psh-ks.net/repository/docs/397_Vendim-Themelohet_Njesiti_per_Luftimin_e_Korrupsionit_Krimeve.pdf

HYRJE

Objekt i këtij raporti janë veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (*tutje MPN*), ndërsa periudha kohore është nëntë (9) vjeçare dhe përfshinë vitet 2013-2021. Raporti përmbanë të dhënat nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, prokuroritë dhe gjykatat lidhur me hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e kryesve të këtyre veprave.

Në fillim të këtij raporti është përshkruar historiku i krijimit të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, akterët e këtij mekanizmi, grupimet e veprave penale karakteristike si dhe të dhënat që regjistrohen dhe gjenerohen nga baza e të dhënave të këtij Mekanizmi. Theksojmë se për shkak se mos ofrimit të të dhënave nga KGJK-ja lidhur me dënimin për veprat penale karakteristike në dy vitet e fundit, është pamundësuar trajtimi dhe krahasimi në këtë raport⁶.

Në pjesën e parë të raportit pasqyrohen në dhënat lidhur me rastet penale të parashtruara nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale si dhe mënyra e regjistrimit të tyre sipas regjistrave në prokurori. Në vazhdim pasqyrohet trendi i procedimit të rasteve penale dhe personave të përfshirë në rastet penale. Ngarkesa me lëndë dhe persona sipas veprave penale dhe sipas prokurorive pasqyrohet para veprimeve dhe vendimeve të prokurorëve. Performanca në procedimin e personave është pjesë përbërëse e pjesë së parë të raportit, duke përfshirë edhe të dhënat lidhur me vendimet e gjykatave dhe ankimin e prokurorive. Në këtë pjesë pasqyrohen edhe të dhënat për rastet penale të regjistruara në regjistrin PPN, duke përfshirë subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, mënyrën e mbylljes së rasteve penale dhe personave si dhe trendet e ngarkesës me raste penale dhe persona. Në fund të kësaj pjese pasqyrohen ngarkesa me raste penale dhe persona në fund të vitit 2021.

Pjesa e dytë e raportit përmbanë aspekte të analizës krahasimore mbi të dhënat e pasqyruara në pjesën e parë të këtij raporti, për veprat penale karakteristike të “MPN-së”. Në këtë pjesë pasqyrohet analiza krahasimore në mes aktakuzave të ngritura në raport me hudhjet e kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve, për rastet penale të kryera përgjatë nëntë (9) viteve 2013-2021, të funksionimit të “MPN”. Analiza në vijim pasqyron të dhënat për përfundimin e ndjekjes penale në raport me numrin e personave të hetuar, respektivisht të përfshirë në kallëzimet penale për vepra penale karakteristike. Pas analizës mbi përfundimin e ndjekjes penale, në pasqyrohet analiza krahasimore për personat e hetuar, ndjekur penalisht dhe të gjykuar, sipas llojit të veprave penale karakteristike dhe sipas prokurorive konkrete. Për më tej, kjo analizë krahasimore shtrohet në nivelin e të gjitha prokurorive themelore dhe prokurorisë speciale. Në pjesën e dytë pasqyrohet edhe trendi i regjistrimit të rasteve penale në regjistrin PPN, duke përfshirë kronologjinë, sipas viteve, të regjistrimit të rasteve penale për veprat penale karakteristike në të dy regjistrat (PP dhe PPN). Kjo analizë ka përcaktuar nevojën e pasqyrimin të regjistrimit të rasteve penale sipas regjistrin PP dhe regjistrin PPN, në tri prokurori. Analiza krahasimore në prokurorinë speciale i referohet dy grupeve të veprave penale, analiza krahasimore në PTh.Prishtinë i adresohet një grupi të veprave penale ndërsa në PTh.Pejë analiza i referohet dy grupe të veprave penale karakteristike.

Në bazë të të gjeturave të raportit janë nxjerrë konstatime dhe janë ofruar rekomandimet konkrete, duke përfshirë shtojcat: dokumente ndihmëse për realizimin e rekomandimeve.

⁶ Për periudhën 2013-2019, 20167 persona ishin të dyshuar për veprat penale karakteristike, për 11858 persona ishin ngritur aktakuza, ndërsa gjykata kishin shpallur fajtor 6335 persona. Për vitet 2020 dhe 2021 KGJK nuk ka ofruar të dhënat mbi dënimet me arsytimin se janë në fazën e rregullimit të raportimit nga të dhënat e SMIL-it.

A. SUBJEKTET E MEKANIZMIN PËRCJELLËS NDËRINSTITUCIONAL

Raporti i mekanizmit përcjellës ndërinstitucional është pronësi e të gjitha institucioneve dhe subjekteve që përbëjnë sistemin e mekanizmit përcjellës, duke përfshirë:

<u>AKRONIMI</u>	<u>SUBJEKTET</u>
KPK	KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
KGJK	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
PK	POLICIA E KOSOVËS
AKK	AGJENCIONI KUNDËR KORRUPSIONIT
DK	DOGANA E KOSOVËS
EPK	E PRANUAR NË KOMPETENCË
E	EULEX
ATK	ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
IPK	INSPEKTORIATI POLICOR I KOSOVËS
NJIF	NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE
AGJ	AUDITORI GJENERAL
APK	AUTORITETI PYJOR I KOSOVËS
AKP	AGJENCIONI KOSOVAR I PRONËS
OAK	ORGANI I ADMINISTRATËS KOMUNALE
ID	I DËMTUARI
PV	PROKURORI ME VET-INICIATIVË
TP	TITULLARI I PRONËS
Q	TË TJERA (QYTETARI)

B. KLASIFIKIMI DHE KATEGORIZIMI I VEPRAVE PENALE KARAKTERISTIKE

Objekt i mekanizmit përcjellës janë nëntë (9) grupe të veprave penale karakteristike, të kategorizuara si në vijim:

CILËSIMI I VEPRAVE PENALE SIPAS KALLËZIMIT PENAL	
Veprat penale që kanë të bëjnë me ARMËT (shkurtesa "A")	
Kodi ri-neni: 364 Kodi vjetër-neni:372	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse
Veprat penale që kanë të bëjnë me DROGA (shkurtesa "DR")	
K.Ri_267 & K.Vj_273	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge
K.Ri_268 & K.Vj_274	Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike
K.Ri_269 & K.Vj_275	Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge
K.Ri_270 & K.Vj_276	Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope
K.Ri_271 & K.Vj_277	Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge
K.Ri_272 & K.Vj_278	Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit
K.Ri_273 & K.Vj_279	Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope
K.Ri_274 & K.Vj_280	Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull
Veprat penale që kanë të bëjnë me KONTRABANDIM ME MIGRANT (shkurtesa "KM")	
K.Ri_164 & K.Vj_170	Kontrabandimi me migrant
Veprat penale që kanë të bëjnë me KRIM TË ORGANIZUAR (shkurtesa "KO")	
K.Ri_277 & K.Vj_283	Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar
Veprat penale që kanë të bëjnë me KORRUPSIONI (shkurtesa "KORR")	
K.Ri_284 & K.Vj_290	Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike
K.Ri_285 & K.Vj_291	Lidhja e kontratës së dëmshme
K.Ri_310 & K.Vj_316	Dhënia e rryshfetit në sektorin privat/Dhënia e paarsyeshme e dhuratave
K.Ri_414 & K.Vj_422	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
K.Ri_416 & K.Vj_423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare
K.Ri_417 & K.Vj_424	Konflikti i interesit
K.Ri_418 & K.Vj_425	Përvetësimi në detyrë
K.Ri_419 & K.Vj_426	Mashtrimi në detyrë
K.Ri_420 & K.Vj_427	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
K.Ri_421 & K.Vj_428	Marrja e rryshfetit
K.Ri_422 & K.Vj_429	Dhënia e rryshfetit
K.Ri_423 & K.Vj_430	Dhënia e rryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar
K.Ri_424 & K.Vj_431	Ushtrimi i ndikimit
K.Ri_425 & K.Vj_432	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
K.Ri_426 & K.Vj_433	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
K.Ri_427 & K.Vj_434	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
K.Ri_428 & K.Vj_435	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
K.Ri_429 & K.Vj_436	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
K.Ri_430 & K.Vj_437	Mos raportimi ose raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare
K.Vj_399 K.Vj_350	Lirimi i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria
Veprat penale që kanë të bëjnë me SHPËRLARJE TË PARAVE (shkurtesa "SHP")	
K.Ri_302 K.Vj_308	Shpërlarja e Parave & Ligji Nr.03 /L-196
Veprat penale që kanë të bëjnë me TRAFIKIM ME NJERËZ (shkurtesa "TNJ")	
K.Ri_163 & K.Vj_169	Skllavëria, kushtet e ngajshme me skllavërinë dhe puna e detyruar

K.Ri_165 & kvj_171	Trafikimi me njerëz
K.Ri_172 & kvj_140	Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave
K.Ri_228 & K.Vj_231	Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit
K.Ri_227 & K.Vj_235	Dhunimi/Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjet (16) vjet
K.Ri_239 & K.Vj_246	Martesa e detyruar- <i>Nëse ka elemente të trafikimit</i>
K.Ri_259 & K.Vj_265	Transplatimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organëve dhe qelizave njerëzore
Veprat penale që kanë të bëjnë me KRIMET EKONOMIKE (shkurtesa "E")	
K. Ri_278 & K.Vj_284	Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike
K. Ri_279 & K.Vj_285	Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike
K. Ri_280 & K.Vj_286	Shkaktimi i falimentimit
K. Ri_281 & K.Vj_287	Shkaktimi i falimentimit të rrejshëm
K. Ri_282 & K.Vj_288	Mashtrimi në procedurën e falimentimit
K. Ri_283 & K.Vj_289	Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve
K. Ri_286 & K.Vj_292	Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar
K. Ri_287 & K.Vj_293	Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës
K. Ri_288 & K.Vj_294	Falsifikimi i shenjave me vlerë
K. Ri_289 & K.Vj_295	Cenimi i të drejtave të patentës
K. Ri_290 & K.Vj_296	Cenimi i të drejtave të autorit
K. Ri_291 & K.Vj_297	Shmangja e masave teknologjike
K. Ri_292 & K.Vj_298	Mashtrimi i konsumatorëve
K. Ri_293 & K.Vj_299	Mashtrimi i blerësve
K. Ri_294 & K.Vj_300	Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm
K. Ri_295 & K.Vj_301	Keqpërdorimit i pozitës së monopolit
K. Ri_296 & K.Vj_302	Falsifikimi i parasë
K. Ri_297 & K.Vj_303	Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketimit, masave dhe peshave të rreme
K. Ri_298 & K.Vj_304	Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim
K. Ri_299 & K.Vj_305	Tregtia e ndaluar
K. Ri_300 & K.Vj_306	Prodhimi i ndaluar
K. Ri_301 & K.Vj_307	Lëshimi çëqeve pa mbulesë ose të rreme dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit
K. Ri_303 & K.Vj_309	Marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender
K. Ri_304 & K.Vj_310	Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë
K. Ri_305 & K.Vj_311	Keqpërdorimi i informatave të brendshme
K. Ri_306 & K.Vj_312	Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë
K. Ri_307 & K.Vj_313	Shmangja nga tatimi
K. Ri_308 & K.Vj_314	Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin
K. Ri_309 & K.Vj_315	Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave/Pranimi i rryshfetit në sektorin privat
K. Ri_311 & K.Vj_317	Kontrabandimi i mallrave
K. Ri_312 & K.Vj_318	Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore
Veprat penale që kanë të bëjnë me NXITJEN E URREJTJES (shkurtesa "NU")	
K. Ri_141 & K.Vj_147	Nxitja e përçarjes dhe mos durimit (<i>sipas kodit të ri</i>) Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik/

C. TË DHËNAT QË REGJISTROHEN NË MEKANIZMIN PËRCJELLËS

Në sistemin e mekanizmit përcjellës (*bazën e të dhënave*) regjistrohen informatat për persona, kallëzimet penale “PP” dhe informatat “PPN” për veprat penale karakteristike dhe personat e përfshirë në veprat (*e pretenduara*) penale, si në vazhdim:

1. Të dhënat/ shënimet për rastet:	
1	Lloji i regjistrit
2	Emërtimi i Prokurorisë
3	Numri i kallëzimit penal (PP) - raportit, nga Regjistri-PPN
4	Shkurtesat e grupeve të veprave penale karakteristike
5	Data e kryerjes së veprës penale
6	Kallëzimi është paraqitur nga
7	Numri referent i parashtruesit të kallëzimit Penal
8	Data e paraqitjes së kallëzimit penal - Raportit
9	Numri i personave të dyshuar
10	Emri i Prokurorit të cilit iu është ndarë rasti
11	Numri i kallëzimit penal - Raportit
2. Të dhënat për veprimet procedurale sipas personave	
1	Emri i të dyshuarit
2	Cilësimi i Veprës Penale sipas Kallëzimit Penal
3	Urdhëri për ndalim
4	Hudhja e Kallëzimit Penal-Mbyllja e Raportit
5	A janë kërkuar informata shtesë
6	A janë urdhëruar masa të fshehta para fillimit të hetimit
7	Fillimi i hetimit
8	Me fillimin e hetimit është kërkuar paraburgimi
9	A është aprovuar kërkesa për caktimin e paraburgimit
10	Ankesa e Prokurorit në vendimin për refuzim të ankesës
11	A është aprovuar ankesa e Prokurorit nga Gjykata Apelit
12	Zgjerimi i Hetimit
13	Cilësimi juridik i VP sipas Aktvendimit për fillimin hetimeve:
14	Pezullimi i Hetimit
15	Rifillimi i hetimit pas Pezullimit të Hetimit
16	Pushimi Hetimit
17	Aktakuzë me kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor
18	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë
19	Me ngritjen e Aktakuzës së Drejtpërdrejtë është kërkuar caktimi i paraburgimit
20	A është aprovuar kërkesa për caktimin e paraburgimit
21	Ankesa e Prokurorit në vendimin për refuzimin e ankesës
22	A është aprovuar kërkesa e Prokurorit nga Gjykata Apelit
23	Aktakuzë pas zhvillimit të Hetimeve
24	Cilësimi juridik i Veprës Penale sipas aktakuzës
25	Ndryshimi i Aktakuzës sipas nenit 252
26	Hudhja e Aktakuzës para shqyrtimit Gjyqësor
27	I Akuzuari është Shpallur fajtor
28	I Akuzuari është Liruar nga Aktakuza
29	Për të Akuzuarin është Refuzuar Aktakuza

30	Cilësimi i Vepres Penale sipas Aktgjykimit
31	Ankesa e Prokurorit vetëm për vendimin mbi dënimin
32	Ankesa e Prokurorit për arsye tjera (përveç lartësisë Dënimit)
33	Përgjigja e Prokurorit në Ankesë
34	A është aprovuar ankesa Prokurorit në vendimin e shkallës-I-
35	Cilësimi juridik i VP sipas aktgjykimit të shkallës -II-
36	Urdhëri për ngrirjen e Aseteve (neni 264)
37	Kërkesë për dhënien e Urdhërit Ndalues (neni 265)
38	A është aprovuar kërkesa e Prokurorit për dhënien e urdhërit ndalues (neni 265)
39	Kërkesa për konfiskim të përkohshëm gjatë hetimit
40	Vlera e sendeve të konfiskuara përkohësisht (në €)
41	Sendet e konfiskuara përkohësisht janë ruajtur në Polici
42	Sendet e konfiskuara përkohësisht janë ruajtur në AAPSK
43	Kërkesë për konfiskim të përkohshëm me Aktakuzë
44	A është aprovuar kërkesa për konfiskim të Përhershëm
45	Vlera e sendeve të konfiskuara (në €)
46	A është kërkuar vendimi për shitjen e sendeve të konfiskuara
47	A është aprovuar Ankesa e Prokurorit
48	Sendet e konfiskuara janë asgjësuar
49	Sendet e konfiskuara janë shitur
50	Sendet e konfiskuara janë dhënë qeverisë në shfrytëzim

3. Të dhënat për sekuestrim dhe konfiskimit:

A	Kërkesë për sekuestrim e pasurisë që rezulton nga veprimet korruptive	B	Kërkesë për sekuestrim e pasurisë që rezulton nga veprimet tjera penale
1	Urdhëri për sekuestrimin e përkohshëm, neni 112.2		
2	Kërkesa e prokurorit parashtruar Gjyqtarit të Procedurës Paraprake për dhënien e Urdhërit për Sekuestrimin e përkohshëm, 112.3		
3	Kërkesa e prokurorit për konfiskimin e ndërtesave, pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme si dhe mjeteve financiare, 241.1.9		
4	Kërkesa të APROVUARA - (nga numrat rendor 3 dhe 4)		
5	Kërkesa e prokurorit për dhenien e asetëve në shfrytëzim të Qeverisë, neni 284.4		
6	Kërkesa të APROVUARA - (nga numri rendor 5)		
7	Kërkesa e prokurorit për dhenien e asetëve në administrim të AAPSK (neni 269)		
8	Kërkesa e prokurorit për kompenzimin e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara, 284.5		
9	Kërkesa të APROVUARA - (nga numrat rendor 7 dhe 8)		

PJESA E PARË

TRENDET

1.MËNYRA E REGJISTRIMIT TË RASTEVE PENALE KARAKTERISTIKE

1.1 RASTET PENALE TË PARASHTRUARA NGA SUBJEKTET

Përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021), subjektet parashtruese të kallëzimeve penale kanë parashtruar në prokurori 21820 raste penale me 34635 persona të përfshirë në veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (*shih figurën 1*). Sipas kriterit të subjektet, kallëzimet penale janë parashtruar nga:

- **INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA**⁷: **91%** të rasteve penale dhe **88%** të personave,
- **QYTETARËT (ID & Q)**⁸: **9%** të rasteve penale dhe **12%** të personave.

#		A		DR		KM		KO		KORR		SHP		TNJ		E		NU		TOTALI	
		Rast	Pers	Rast	Person	Rast	Pers	Rast	Perso	Rast	Person	Rast	Pers	Rast	Per	Rast	Perso	Rast	Pe	Rast	Person
1	PK	126	262	8107	10756	272	587	52	553	2747	5181	224	511	376	693	3803	4811	35	76	15742	23430
2	AKK	0	0	0	0	0	0	0	0	921	1147	3	5	0	0	1	1	0	0	925	1153
3	EPK	1	1	67	110	10	52	38	194	707	1644	33	103	16	52	140	261	1	1	1013	2418
4	DK	0	0	1	2	0	0	4	47	21	78	24	26	0	0	523	602	0	0	573	755
5	ATK	0	0	2	4	0	0	2	5	9	10	1	2	0	0	332	431	0	0	346	452
6	PV	2	5	56	164	8	11	5	66	154	306	5	14	3	7	58	100	0	0	291	673
7	IPK	0	0	4	6	2	2	4	7	254	492	1	1	0	0	11	19	1	1	277	528
8	OAK	0	0	17	24	0	0	1	3	55	90	0	0	0	0	19	21	0	0	92	138
9	TP	0	0	0	0	0	0	1	10	98	136	0	0	0	0	21	31	0	0	120	177
10	APK	0	0	0	0	0	0	0	0	39	44	0	0	0	0	9	14	0	0	48	58
11	E	1	1	3	6	4	15	4	41	101	198	4	9	0	0	0	0	0	0	117	270
12	AKP	0	0	0	0	0	0	0	0	19	26	0	0	0	0	1	1	0	0	20	27
13	NJIF	0	0	1	1	2	11	0	0	204	288	25	53	0	0	1	1	0	0	233	354
14	AGJ	0	0	0	0	0	0	1	4	47	53	0	0	0	0	0	0	1	1	49	58
15	ID	0	0	0	0	0	0	0	0	1012	2055	0	0	1	2	48	72	3	3	1064	2132
16	Q	0	0	9	25	4	8	37	187	812	1694	5	11	2	4	36	78	5	5	910	2012
Gjithsej:		130	269	8267	11098	302	686	149	1117	7200	13442	325	735	398	758	5003	6443	46	87	21820	34635

Figura 1

Policia me 72% të rasteve penale dhe 68% të personave, rezulton të ketë nivelin më të lartë të parashtrimit të kallëzimeve penale, ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Agjencioni Kosovar i Pronës, me 0.09% të rasteve penale dhe 0.08% të personave. Konstatohet se mbi 90% e kallëzimeve penale janë proceduar nga institucionet e specializuara ndërsa 9% nga qytetarët (ID & Q). Konstatohet se 4.64% apo 1013 kallëzime penale janë regjistruar të parashtruar nga subjekti “E pranuar në kompetencë” (EPK), që sipas kriterit sasior rezulton si i treti (3) me renditjen e subjekteve, pas Policisë (15742 raste) dhe I dëmtuari (1064 raste).

⁷ Neni 78 Kallëzimi penal nga organet publike dhe Neni 81 kallëzimi penal nga Policia, Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.37/28 dhjetor 2012, Prishtinë..

⁸ Neni 79 Kallëzimi penal nga Personat, Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.37/28 dhjetor 2012, Prishtinë.

1.2 MËNYRA E REGJISTRIMIT TË RASTEVE PENALE KARAKTERISTIKE

Nga tërësia e 21820 rasteve penale të pranuar nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021), prokuroritë i kanë regjistruar (*shih figurën 2*) si në vijim:

- **76%** në regjistrin **PP**
- **24%** në regjistrin **PPN**.

		# raste penale	Regjistruar në regjistrin PP	Regjistruar në regjistrin PPN
1	A	130	124 (95%)	6 (5%)
2	DR	8267	8000 (97%)	267 (3%)
3	KM	302	264 (87%)	38 (13%)
4	KO	149	99 (66%)	50 (34%)
5	KORR	7200	3910 (54%)	3290 (46%)
6	SHP	325	90 (28%)	235 (72%)
7	TNJ	398	354 (89%)	44 (11%)
8	E	5003	3627 (72%)	1376 (28%)
9	NU	46	46 (100%)	0 (%)
	Totali:	21820	16514 (75.68%)	5306 (24.32%)

Figura 2

Në aspektin krahasimor të regjistrimit të rasteve në regjistrat respektiv, konstatojmë si në vijim.

- SHPËRLARJA E PARASË: Tre (3) nga katër (4) rastet janë regjistruar PPN,
- KORRUPSIONI: Një (1) nga dy (2) raste është regjistruar PPN,
- KRIMI ORGANIZUAR: Një (1) nga tri (3) raste është regjistruar PPN,
- KRIME EKONOMIKE: Një (1) nga katër (4) raste është regjistruar PPN,
- NXITJA URREJTJES: 0 raste të regjistruara në regjistrin PPN (*shih figurën 3*).




Figura 3

2.RASTET PENALE TË REGJISTRUARA NË REGJISTRIN 'PP'

2.1 RASTET PENALE ‘PP’ TË PARASHTRUARA NGA SUBJEKTET

Prokuroritë përgjatë viteve 2013-2021 në regjistrin PP kanë regjistruar **16514** raste penale me **26329** persona të përfshirë në veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (*shih figurën 4*), të cilat sipas subjekteve janë parashtruar si në vijim:

- **INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA⁹**: **94%** të rasteve penale dhe **92%** të personave,
- **QYTETARËT¹⁰**: **6%** të rasteve penale dhe **8%** të personave.

#		A		DR		KM		KO		KORR		SHP		TNJ		E		NU		TOTALI	
		Rast	P	Rast	Person	Rast	P	Rast	P	Rast	Person	Rast	P	Rast	P	Rast	P	Rast	P	Rast	Person
1	PK	120	232	7845	10427	241	526	40	439	1524	3321	41	107	335	633	2669	3604	35	76	12850	19365
2	AKK									869	1071	1	3							870	1074
3	ID									497	1015			1	2	30	40	3	3	531	1060
4	EPK	1	1	65	108	6	42	24	164	271	785	22	83	14	50	95	201	1	1	499	1435
5	DK			1	2			2	41	13	68	7	8			414	485			437	604
6	Q			8	24	2	2	19	105	368	874	3	8	1	3	30	70	5	5	436	1091
7	ATK			2	4			1	2	5	5	1	2			291	384			300	397
8	PV	2	5	56	164	8	11	5	66	87	229	5	14	3	7	48	87			214	583
9	IPK			3	5	2	2	2	5	142	307					11	19	1	1	161	339
10	OAK			17	24			1	3	27	50					15	17			60	94
11	TP							1	10	43	60					14	24			58	94
12	APK									35	39					9	14			44	53
13	E	1	1	3	6	4	15	4	41	6	18	4	9							22	90
14	AKP									18	22					1	1			19	23
15	NJIF					1	10					6	10							7	20
16	AGJ									5	6							1	1	6	7
		124	239	8000	10764	264	608	99	876	3910	7870	90	244	354	695	3627	4946	46	87	16514	26329

Figura 4

Policia me **77%** të rasteve penale rezulton të ketë nivelin më të lartë të parashtrimit të kallëzimeve penale, sipas kriterit të subjektit.

Konstatohet se **94%** të kallëzimeve penale të regjistruara në regjistrin PP janë parashtruar nga institucionet e specializuara, ndërsa **6%** janë parashtruar nga qytetarët (*Q dhe ID*).

Konstatohet se **3%** apo **499** kallëzime penale janë regjistruar si raste të parashtruar nga subjekti “E pranuar në kompetencë” (*EPK*).

⁹ Neni 78 Kallëzimi penal nga organet publike dhe Neni 81 kallëzimi penal nga Policia, Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.37/28 dhjetor 2012, Prishtinë

¹⁰ Neni 79 Kallëzimi penal nga Personat, Kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.37/28 dhjetor 2012, Prishtinë

2.2 PROCEDIMI I RASTEVE PENALE SIPAS LLOJIT TË VEPRAVE PENALE KARAKTERISTIKE

Nga tërësia prej 16445 rasteve të pranura përgjatë nëntë (9) viteve: 2013-2021, prokuroritë kanë proceduar **90.68%** apo 14911 raste penale, prej tyre në vitin 2018 dhe 2019 është proceduar numri më i lartë i rasteve penale se sa në vitet pasuese edhe përkundër rritjes së numrit të prokurorëve (*shih figurën 5*).

	2013		2014		2015		2016		2017		2018		2019		2020		2021		Total 2012-2021		
	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	%
A	37	19	23	27	12	12	14	7	11	14	12	17	5	10	7	4	3	6	124	116	93.55%
DR	374	257	511	350	438	339	725	455	1061	856	1556	1614	1328	1289	906	822	1105	1088	8004	7070	88.33%
KM	45	29	56	35	39	33	17	22	25	24	17	11	16	20	24	21	25	14	264	209	79.17%
KO	11	2	21	8	14	8	4	13	13	7	1	13	8	13	8	7	19	7	99	78	78.79%
KORR	435	314	502	444	412	412	438	468	443	456	325	408	419	400	379	329	485	409	3838	3640	94.84%
SHP	18	25	10	14	9	7	4	6	8	7	5	9	12	3	15	9	9	9	90	89	98.89%
TNJ	48	34	33	23	25	17	32	25	43	43	64	46	43	37	20	17	46	38	354	280	79.10%
E			647	451	379	276	343	407	496	498	413	435	502	532	380	325	467	470	3627	3394	93.58%
NU					8	5	7	5	8	7	5	5	9	6	3	4	4	3	44	35	79.55%
#	969	680	1803	1352	1336	1109	1584	1408	2108	1912	2398	2558	2342	2310	1742	1538	2163	2044	16445	14911	90.68%

Figura 5

Në vitin 2018 është arritur niveli më i lartë i procedimit të rasteve penale për veprat penale karakteristike të MPN-së, ndërsa në vitet pasuese 2019, 2020 dhe 2021, kemi ulje të nivelit të performancës në procedimin e rasteve penale, si pasojë e zvogëlimit të numrit të të prokurorëve¹¹ në prokuritë themelore dhe PSRK (*shih figurën 6*).




Figura 6

¹¹ Në vitin 2018 në prokuroritë themelore dhe PSRK ishin 178 prokurorë (*Informatë nga NJSHP-jë*), ndërsa aktualisht (2022) janë 153 prokurorë.

2.3 PROCEDIMI I RASTEVE PENALE SIPAS PROKURORIVE

PTh. Prizren me 100.60% të procedimit të rasteve penale është prokuroria e vetme që për nëntë (9) vite (2013-2021) ka proceduar më shumë raste penale në raport me rastet penale të pranuar ndërsa, PTh.Mitrovicë me kuotën prej 78.83% të prcedimit të rasteve penale rezulton të ketë nivelin më të ulët procedimit të rasteve penale për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (shih figurën 7 dhe 8).

	PSRK		PRISHTINE		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		TOTAL	
	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z
A	11	15	22	11	47	51		1	11	8	4	1	22	24	7	5	124	116
DR	17	25	2836	2256	1310	1296	808	763	768	717	957	794	843	827	473	392	8004	7070
KM	18	13	77	48	51	45	5	5	56	52	19	13	17	17	21	16	264	209
KO	98	77	1			1											99	78
KORR	218	197	1453	1370	528	557	369	347	440	430	310	248	252	254	268	237	3838	3640
SHP	84	87			6	2											90	89
TNJ	4	4	113	82	51	39	34	27	29	25	40	31	59	53	24	19	354	280
E	10	11	1034	1019	709	727	283	266	506	498	442	311	468	407	175	155	3627	3394
NU	6	3	8	6	9	9	11	9	1	1	4	2	4	3	1	2	44	35
#	466	432	5544	4792	2711	2727	1510	1418	1812	1731	1776	1400	1665	1585	969	826	16444	14911

Figura 7




Figura 8

P- Lëndë të pranuar **Z- Lëndë të proceduara/zgjidhura**

2.4 NGARKESËS ME LËNDË SIPAS LLOJIT TË VEPRAVE PENALE

Përkundër uljes së numrit të rasteve të pranuar në tri vitet e fundit (në vitin 2019 janë pranuar 2342 raste, në 2020 janë pranuar 1742 raste dhe në 2021 janë pranuar 2163 raste), në raport me vitin 2018 në të cilin janë pranuar 2398 raste penle karakteristike, ngarkesa me raste penale është rritur në vazhdimisë, në këto tri vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021 (shih figurën 9).

	2013	+/-	2014	+/-	2015	+/-	2016	+/-	2017	+/-	2018	+/-	2019	+/-	2020	+/-	2021
A	29	-3	26	+4	30	+6	36	-6	30	+3	33	-11	22	+3	25	-3	22
DR	286	+159	445	+121	566	+262	828	+174	1002	-89	913	+31	944	+84	1028	+17	1045
KM	37	-22	59	+7	66	-10	56	-6	50	+3	53	-2	51	+3	54	+11	65
KO	25	+14	39	+8	47	-7	40	+3	43	-10	33	+1	34	+1	35	+12	47
KORR	464	+68	532	+6	538	-91	447	-131	316	-86	230	+37	267	+50	317	+76	393
SHP	31	-2	29	+3	32	-3	29	0	29	-11	17	+11	28	+6	34	0	34
TNJ	34	+10	44	+7	51	+6	57	+9	66	+14	80	+9	89	+3	92	-44	48
E		+488	488	+97	585	-118	467	-76	391	-11	380	-11	369	+55	424	-3	421
NU									0	+14	14	+2	16	-2	14	+1	15
#	893	+769	1662	+253	1915	+45	1960	-33	1927	-174	1753	+67	1820	+203	2023	+67	2090

Figura 9

Në 2018 janë pranuar 2398 ndërsa janë proceduar 106.67% apo 2558 raste dhe ngarkesa me lëndë të mbetura ishte 1753 raste penale. Në 2019 janë pranuar 2342 ndërsa janë proceduar 98.63% apo 2310 raste dhe ngarkesa është rritur për 4% në raport me vitin 2018. Në 2020 janë pranuar 1742 ndërsa janë proceduar 88.29% apo 1538 raste dhe ngarkesa është rritur për 11% në raport me vitin 2019. Në 2021 janë pranuar 2163 ndërsa janë proceduar 94.50% apo 2044 raste dhe ngarkesa është rritur për 3% nga 2020 (shih figurën 10).




Figura 10

2.5 NGARKESA ME LËNDË SIPAS PROKURORIVE

Ngarkesa me lëndë në fund të vitit 2021 (31.12.2021), rezulton me 2090 raste penale (shih figurën 11).

31.12.2021	A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU	Totali
PSRK	1	3	8	47	60	34	1		9	163
PRISHTINË	12	643	26		117		9	158	4	969
PRIZREN		19	8		17		15	28		87
PEJË		31	1		25		4	22	1	84
GJILAN		10	3		14			7		34
MITROVICË	5	253	11		105		10	162	1	547
FERIZAJ	2	10	2		19		7	12		52
GJAKOVË	2	76	6		36		2	32		154
#	22	1045	65	47	393	34	48	421	15	2090

Figura 11

Niveli më i lartë i ngarkesës me lëndë nga totali i ngarkesës i adresohet: PTh.Prishtinë me 46% dhe PTh.Mitrovicë me 26%, ndërsa së bashkur 72% (shih figurën 12).




Figura 12

Niveli më i lartë të i ngarkesës i lëndë sipas llojit të veprave penale i adresohet Drogave me 50%, Krimet ekonomike me 20% dhe Korrupsionit me 19%, ndërsa së bashkut këto tri grupe të veprave penale karakteristike përbëjnë 89% të totalit të ngarkesës me lëndë më, 31.12.2021 (shih figurën 13).




Figura 13

2.6 PROCEDIMI I PERSONAVE SIPAS LLOJIT TË VEPRAVE PENALE

Nga tërësia prej 26330 personave të përfshirë në veprat penale karakteristik përgjatë nëntë (9) viteve: 2013-2021, prokuroritë kanë proceduar **93.33%**, prej tyre në dy vitet e fundit (2020 dhe 2021) është proceduar numri më i ulët i personave në raport me tri vitet paraprake (2017, 2018 dhe 2019). Shpërlarja e parasë me **133.20%**, rezultun të jetë grupi i vetëm i veprave penale me tejkalim të 100% të procedimit të personave, ndërsa në kontekst të mënyrës së procedimit rezultun se për 224 persona është hudhur kallëzimi penale apo është pushuar hetimi ndërsa për 97 persona është ngritur aktakuzë (shih figurën 14).

	2013		2014		2015		2016		2017		2018		2019		2020		2021		Total 2013-2021		
	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	%
A	69	39	44	63	17	29	25	21	14	21	41	16	7	12	14	24	8	6	239	231	96.65%
DR	612	429	793	554	652	560	990	633	1414	1208	2009	2065	1727	1612	1217	1086	1351	1391	10765	9538	88.60%
KM	127	116	118	103	86	91	40	55	52	43	34	19	23	31	44	41	84	27	608	526	86.51%
KO	85	9	165	127	156	113	83	183	94	126	7	70	76	106	62	34	148	54	876	822	93.84%
KORR	1036	668	1011	1016	860	897	849	1164	738	1004	656	771	896	771	778	697	1046	796	7870	7784	98.91%
SHP	36	116	25	43	27	15	7	17	23	16	11	28	57	11	39	44	19	35	244	325	133.20%
TNJ	113	148	93	57	67	63	76	72	74	81	90	97	80	58	32	31	70	63	695	670	96.40%
E			737	519	525	338	487	512	637	660	580	637	736	712	600	478	644	742	4946	4598	92.96%
NU					40	29	9	16	12	11	8	8	11	7	3	6	4	3	87	80	91.95%
#	2078	1525	2986	2482	2430	2135	2566	2673	3058	3170	3436	3711	3613	3320	2789	2441	3374	3117	26330	24574	93.33%

Figura 14

Në vitin 2018 është arritur niveli më i lartë i procedimit të personave (3711) për veprat penale karakteristike, ndërsa në vitet pasuese 2019, 2020 dhe 2021, kemi ulje të nivelit të performancës në procedimin e personave, që është pasojë e zvogëlimit të numrit të prokurorëve¹² në prokuroritë themelore dhe PSRK (shih figurën 15).




Figura 15

¹² Në vitin 2018 në prokuroritë themelore dhe PSRK ishin 178 prokurorë (Informatë nga NJSHP-jë), ndërsa aktualisht (2022) janë 153 prokurorë

2.7 PROCEDIMIT TË PERSONAVE SIPAS PROKURORIVE

PSRK me 109.80% dhe PTh. Prizren me 101.60% të personave të proceduar (zgjdhur/kryer) për veprat penale karakteristike përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021), janë prokuroritë e vetme që kanë proceduar numër më të lartë të personave në raport me numrin e pranuar të personave ndërsa, PTh.Mitrovicë me 78.42% ka nivelin më të ulët procedimit të personave (shih figurën 16 dhe 17).

	PSRK		PRISHTINE		PRIZREN		PEJË		GJILAN		MITROVICË		FERIZAJ		GJAKOVË		TOTAL	
	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z	P	Z
A	18	49	43	28	62	65		1	23	18	11	6	68	55	14	9	239	231
DR	80	110	3753	3010	1825	1806	1085	1029	936	879	1313	1050	1132	1102	641	552	10765	9538
KM	99	156	178	114	114	86	12	12	89	79	53	21	33	33	30	25	608	526
KO	872	806	4			14								2			876	822
KORR	916	966	2906	2910	1058	1125	639	574	778	784	616	505	529	527	428	393	7870	7784
SHP	233	322			11	3											244	325
TNJ	15	49	241	225	70	60	72	56	53	46	90	93	112	104	42	37	695	670
E	66	68	1395	1329	896	940	381	354	704	676	590	423	675	602	239	206	4946	4598
NU	30	32	7	9	11	11	13	11	3	1	10	6	11	7	2	3	87	80
#	2329	2558	8527	7625	4047	4110	2202	2037	2586	2483	2683	2104	2560	2408	1396	1225	26330	24574
	109.80%		89.42%		101.60%		92.51%		96.02%		78.42%		94.06%		87.75%		93.33%	

Figura 16




Figura 17

P- Rastet e pranuar për Persona Z- Rastet e proceduara/zgjdhura për persona

2.8 NGARKESA ME PERSONA SIPAS LLOJIT TË VEPRAVE PENALE

Përkundër uljes së numrit të rasteve të pranuar në dy vitet e fundit (në vitin 2020 janë pranuar 2789 persona dhe në 2021 janë pranuar 3374 persona), në raport me vitin 2019 në të cilin janë pranuar 3613 persona për veprat penale karakteristike, ngarkesa me persona është rritur në vazhdimisë në tri vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021 në raport me vitin 2018 (shih figurën 18).

	2013	+/-	2014	+/-	2015	+/-	2016	+/-	2017	+/-	2018	+/-	2019	+/-	2020	+/-	2021
A	64	-10	54	-1	53	+4	57	-12	45	+28	73	-21	52	-10	42	+2	44
DR	467	+243	710	+131	841	+348	1189	+168	1357	-75	1282	+65	1347	+131	1478	-40	1438
KM	111	+16	127	-3	124	-21	103	+5	108	+9	117	-6	111	+3	114	+57	171
KO	201	+61	262	+92	354	-11	343	-94	249	-108	141	+36	177	+28	205	+94	299
KORR	1496	+62	1558	+82	1640	-392	1248	-508	740	-123	617	+183	800	+81	881	+250	1131
SHP	91	-9	82	+13	95	-30	65	+17	82	-40	42	+47	89	-5	84	-16	68
TNJ	85	+40	125	+10	135	+3	138	-2	136	+13	149	+15	164	+1	165	-89	76
E		+623	623	+177	800	-50	750	-86	664	-71	593	-7	586	+122	708	-98	610
NU										+67	67	+2	69	-3	66	+1	67
	2469	+1072	3541	+501	4042	-149	3893	-512	3381	-300	3081	+314	3395	+348	3743	+161	3904
	8%		11%		13%		12%		11%		10%		11%		12%		12%

Figura 18

Në 2018 janë pranuar 3436 ndërsa janë proceduar 108% apo 3711 persona, ndërsa ngarkesa me persona ishte 3081.

Në 2019 janë pranuar 3613 ndërsa janë proceduar 91.89% apo 3320 persona, ngarkesa është rritur për 10% në raport me vitin 2018.

Në 2020 janë pranuar 2789 ndërsa janë proceduar 87.52% apo 2441 persona, ngarkesa është rritur për 7% në raport me vitin 2019.

Në 2021 janë pranuar 3374 ndërsa janë proceduar 92.38% apo 3117 persona, ngarkesa është rritur për 4% nga 2020 (shih figurën 19).




Figura 19

2.9 NGARKESA ME PERSONA SIPAS PROKURORIVE

Ngarkesa në fund të vitit 2021 (31.12.2021), rezultontë jetë 3904 persona për veprat penale karakteristike (shih figurën 20).

31.12.2021	A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU	#
PSRK	1	3	22	299	300	68	3		59	755
PRISHTINË	15	865	63		359		16	230	4	1552
PRIZREN		37	29		29		17	41		153
PEJË		44	1		75		9	36	1	166
GJILAN		18	3		21			8		50
MITROVICË	16	353	43		213		21	222	3	871
FERIZAJ	7	13	2		66		8	28		124
GJAKOVË	5	105	8		68		2	45		233
#	44	1438	171	299	1131	68	76	610	67	3904

Figura 20

Niveli më i lartë i ngarkesës me persona nga totali i ngarkesës me persona më, 31.12.2021 i adresohet: PTh.Prishtinë me 40%, PTh.Mitrovicë me 22% dhe PSRK me 19% ndërsa, ndërsa këto tri prokurori kanë 72% të ngarkesës me persona (shih figurën 21).




Figura 21

Niveli më i lartë të i ngarkesës i lëndë sipas llojit të veprave penale i adresohet Drogave me 50%, Krimet ekonomike me 20% dhe Korrupsionit me 19%, ndërsa së bashku këto tri grupe të veprave penale karakteristike përbëjnë 89% të totalit të ngarkesës me lëndë më, 31.12.2021 (shih figurën 22).




Figura 22

2.10 VEPRIMET DHE VENDIMET E PROKURORIVE

Prokuroritë kanë marrë 24448 veprime/vendime në kuadër të trajtimit të rasteve të personave të proceduar për veprat penale karakteristike, prej të cilëve niveli më i ulët të veprimeve, përkundër rritjes së numrit të prokurorëve dhe stafit mbështetës, rezulton të jetë në dy vitet e fundit: 2020=7% dhe 2021=9%, (shih figurën 23).

	Total Persona	Urdhëresa për ndalim	Kërkesa për informata shtesë	Urdhëresa për masa të fshehta	Aktvendime për fillimin e hetimeve	Kërkesa për caktimin e paraburgimit	Kërkesa të aprovuara nga Gjykata	Ankesa në vendimet e Gjykatës përkitazi refuzimin e kërkesës	Vendimet Gjykatës së Apelit në lidhje me ankesat	Aktvendim për zgjerimin e	Pezullimi i procedurës	Rifillimi i procedurës pas pezullimit të hetimeve
1 A	416	75	68	20	166	52	19			30	5	
2 DR	7079	1089	741	482	2825	1342	639	39	12	253	200	108
3 KM	1370	231	68	41	504	326	169	18	33	96	63	23
4 KO	1828	65	124	112	675	86	70			594	136	36
5 KORR	8816	424	2584	271	4121	499	202	30	87	613	201	73
6 SHP	390	2	73	21	164	5	4			33	54	38
7 TNJ	1458	307	88	157	482	321	160	8		59	27	9
8 E	3002	213	249	44	2027	225	100	4		134	82	24
9 NU	89	2	2	1	68	3			2	0	13	
Gjithsej:	24448	2408	3997	1149	11032	2859	1363	99	134	1812	781	311
	2013=15%	2014=17%	2015=9%	2016=13%	2017=10%	2018=9%	2019=10%	2020=7%	2021=9%			

Figura 23

Përgjatë viteve 2013-2021 janë proceduar 24574 persona, janë marrë 11032 aktvendime për fillimin e hetimeve, janë parashtruar 2859 kërkesa për caktimin e paraburgimit, prej tyre 48% apo 1363 kërkesa janë aprovuar nga Gjykatat (shih figurën 24).

	Total: Persona	Urdhëresa për ndalim	Kërkesa për informata shtesë	Urdhëresa për masa të fshehta	Aktvendim e për fillimin e hetimeve	Kërkesa për caktimin e paraburgimit	Kërkesa të aprovuara nga Gjykata	Ankesa në vendimet e Gjykatës përkitazi refuzimin e kërkesës	Vendimet Gjykatës së Apelit në lidhje me ankesat	Aktvendim për zgjerimin e hetimeve	Pezullimi i procedurës	Rifillimi i procedurës pas pezullimit të hetimeve
1 PSRK	4116	80	446	163	1693	160	129	8	78	1118	319	129
2 PRISHTINË	6518	741	1397	278	2912	667	287	31	15	298	160	34
3 PRIZREN	3937	594	652	97	1659	591	278	29	4	148	109	58
4 PEJË	2501	93	885	196	944	227	111	2	8	57	37	60
5 GJILAN	2467	400	309	96	1126	446	176	0	7	26	54	10
6 MITROVICË	1476	185	47	84	742	303	191	1	18	69	38	7
7 FERIZAJ	2159	268	78	97	1271	309	137	19	3	65	45	7
8 GJAKOVË	1275	47	184	138	685	156	53	9	1	31	19	6
Gjithsej:	24448	2408	3997	1149	11032	2859	1363	99	134	1812	781	311

Figura 24

2.11 MËNYRA E PROCEDIMIT TË PERSONAVE

Prokuroritë përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021), kanë proceduar rastet e **24574** personave të përfshirë në veprat penale karakteristike, prej tyre **63.52%** janë ngritur aktakuza, për **35.52%** janë hudhur kallëzimet penale apo janë pushuar hetimet dhe 0.96% janë proceduar në mënyra tjera (*shih figurën 25*).

2013-2021	Hudhje të kallëzimit penal	Masa për trajtim të detyrueshëm psikiatrik	Transferimi procedurës penale, të shtetin tjetër	Pushim i hetimeve	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor	Aktakuzë e Drejpërdrejtë	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	Mënyrë tjetër (Bashkim i procedurës)	Gjithsej 2013-2021	
									Nr. personave	%
1	A	12		4	34	24	156	1	231	0.94%
2	DR	753	3	4	453	1036	4345	2904	9538	38.81%
3	KM	22			132	5	365	2	526	2.14%
4	KO	28			331		445	18	822	3.34%
5	KORR	2488	5		2105	90	316	2681	7784	31.68%
6	SHP	79	4		145	1	93	3	325	1.32%
7	TNJ	41	2		111	7	509		670	2.73%
8	E	1326	2	3	638	67	638	1877	4598	18.71%
9	NU	10			20	20	30		80	0.33%
#		4759	16	11	3969	1213	5336	9060	24574	100%
		19.37%	0.07%	0.04%	16.15%	4.94%	21.71%	36.87%	100%	

Figura 25

PSRK-ja është prokuroria e vetme që ka numër më të lartë të hudhjeve të kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve (1330 apo 53%) në raport me aktakuzat e ngritura (1177 apo 47%) për persona (*shih figurën 26*).

Sa i përket regjistrimit të rasteve penale të Korrupsionit në regjistrin PPN, konstatojmë se në vitet 2013 dhe 2014, PSRK-ja ka regjistruar më shumë rastet penale në regjistrin PP. Gjatë viteve 2015-2019 në PSRK më shumë raste penale janë regjistruar në regjistrin PPN. Në dy vitet e fundit 2020 dhe 2021 PSRK-ja ka regjistruar më shumë raste penale të Korrupsionit në regjistrin PP. Nga aspekti kohor 2015-2019 mund të konstatojmë se numri më i lartë të regjistrimit të rasteve penale të Korrupsionit në regjistrin PPN është bërë gjatë periudhës kohore të funksionimit të planit strategjik për ngritjen e efikasitet në luftimin e Korrupsionit. Ndërsa, për sa i përket viteve 2020 dhe 2021, në të cilët është bërë ndryshimi në regjistrimin e më shumë rasteve penale të Korrupsionit në regjistrin PP në raport me regjistrin PPN, kjo periudhë koïncidon me periudhën e udheheqjes së re në PSRK.

4.7.2 SHPËRLARJA E PARASË: PP - PPN

PSRK nga viti 2013 deri në vitin 2021 nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale ka pranuar **314** raste të Shpërlarjes së parasë, të cilat janë regjistruar si në vijim (*shih figurën 57*).

- Regjistri **PPN**: **73%** apo 229 raste penale,
- Regjistri **PP**: **27%** apo 85 raste penale.

SHP	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	#
PP	16 (36%)	11 (46%)	7 (29%)	4 (16%)	8 (30%)	3 (10%)	12 (21%)	15 (47%)	9 (18%)	85 (27%)
PPN	28 (64%)	13 (54%)	17 (71%)	21 (84%)	19 (79%)	27 (90%)	45 (79%)	17 (53%)	42 (82%)	229 (73%)
#	44	24	24	25	27	30	57	32	51	314

Figura 57

PSRK përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021) ka regjistruar më shumë raste penale të Shpërlarjes së parasë në regjistrin PPN, edhe për faktin se 99.36% e rasteve janë parashtruar nga Institucionet e specializuara, prej të cilave vetëm Policia ka parashtruar 179 raste penale apo 79% të tërësisë së rasteve të parashtruara nga Institucionet e specializuara, ndërsa Njësia Inteligjencës Financiare ka parashtruar vetëm 16 raste penale apo 7%.

- INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA: kanë parashtruar **99.36%** apo 227 raste penale,
 - o **Policia**: **79% apo 179 raste penale**
 - o Dogana: **7%** apo 17 raste penale,
 - o Njësia Inteligjencës Financiare: **7%** apo 16 raste penale,
 - o E pranuar në kompetencë: **5%** apo 11 raste penale,
 - o Agjencioni Kundër Korrupsionit: **1%** apo 2 raste penale,
 - o Inspektoriat Policor i Kosovës: **0.5%** apo 1 rast penal,
 - o Prokurori me vetiniciativë: **0.5%** apo 1 rast penal.
- PERSONAT: Qytetarët kanë parashtruar **0.64%** apo 2 raste penale.

Identifikimi dhe zgjidhja e problemit:

PSRK-ja përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021), 73% të rasteve penale të Shpërlarjes së parasë i ka regjistruar në regjistrin PPN, ndërsa 27% të rasteve penale i ka regjistruar në regjistrin PP.

Hipoteza 0: “Rastet penale të shpërlarjes së parasë mund të jenë parashtruar nga Njësia e Inteligjencës Financiare dhe si të tilla, në mungesë të kallëzimit formal, janë regjistruar në regjistrin PPN”. Kjo hipotezë nuk është vërtetuar për faktin se, është Policia e Kosovës subjekti që ka parashtruar shumicën e rasteve penale të Shpërlarjes së parasë, respektivisht Policia ka parashtruar 79% apo 179 të rasteve penale të Shpërlarjes së parasë, ndërsa NJIF ka parashtruar vetëm 7% apo 16 raste penale të Shpërlarjes së parasë.

Hipoteza 1: “Rastet penale të shpërlarjes së parasë mund të jenë parashtruar nga qytetarët dhe si të tilla, në mungesë të informatave të nevojshme, janë regjistruar në regjistrin PPN”. Edhe kjo hipotezë nuk është vërtetuar për faktin se qytetarët gjatë periudhës nëntë (9) vjeçare (2013-2021), kanë parashtruar vetëm 0.64% apo 2 raste penale.

Meqenëse të dy hipotezat nuk janë vërtetuar, konstatohet se PSRK-ja rastet penale të Shpërlarjes së parasë, duhet t'i regjistroj si kallëzime penale në regjistrin PP.

4.8 REGJISTRIMI I RASTEVE PENALE TË KORRUPSIONIT NË PTH.PRISHTINË

Përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021) PTh.Prishtinë nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale ka pranuar 7482 raste penale, prej të cilave në regjistrin PP ka regjistruar 5544 apo 74.10%, ndërsa në regjistrin PPN 1938 apo 25.90% (shih figurën 58).

Raste penale		Regjistri PP	Regjistri PPN
A	23	22 (96%)	1 (4%)
DR	2838	2836 (99.93%)	2 (0.07%)
KM	78	77 (98.72%)	1 (1.28%)
KO	1	1 (100%)	
KORR	3072	1453 (47.30%)	1619 (52.70%)
SHP			
TNJ	116	113 (97.41%)	3 (2.59%)
E	1346	1034 (76.82%)	312 (23.18%)
NU	8	8 (100%)	
	7482	5544 (74.10%)	1938 (25.90%)

Figura 58

PTh.Prishtinë në regjistrin PPN ka regjistruar 1938 raste penale prej tyre **84%** apo 1619 raste penale i përkasin Korruptsionit, andaj në vijim do të trajtojmë këtë grup të veprave penale.

PTh.Prishtinë përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021) nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale ka pranuar **3072** raste penale të Korruptsionit, të cilat sipas regjistrave i ka regjistruar si në vijim (shih figurën 59):

- Regjistri **PPN: 53%** apo 1619 raste penale,
- Regjistri **PP: 47%** apo 1453 raste penale.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	#
PP	126 (68%)	237 (89%)	155 (73%)	159 (39%)	208 (47%)	148 (37%)	164 (42%)	117 (39%)	139 (31%)	1453 (47%)
PPN	58 (%)	28 (11%)	56 (27%)	249 (61%)	234 (53%)	254 (63%)	222 (58%)	180 (61%)	338 (69%)	1619 (53%)
#	184	265	211	408	442	402	386	297	477	3072

Figura 59

Në PTh.Prishtinë **1619** rastet penale të Korruptsionit të regjistruara në regjistrin PPN përgjatë viteve 2013-2021, sipas subjekteve janë parashtruar si në vijim:

- INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA: kanë parashtruar **83.28%** të rasteve penale:
 - o **Policia: 29.28%** apo 474 raste penale,
 - o Njësi Inteligjencës Financiare: **22.30%** apo 361 raste penale,
 - o Eulex: **11.43%** apo 185 raste penale,
 - o E pranuar në kompetencë: **8.71%** apo 141 raste penale,
 - o Inspektoriat Policor i Kosovës: **8.59%** apo 139 raste penale,
 - o Titullari i Pronës: **2.04%** apo 33 raste penale,
 - o Auditori Gjeneral: **1.98%** apo 32 raste penale,
 - o Prokurori me vetiniciativë: **1.91%** apo 31 raste penale,
 - o Agjencioni Kundër Korruptsionit: **1.42%** apo 23 raste penale,
 - o Organi Administratës Komunale: **1.42%** apo 23 raste penale,
 - o Dogana: **0.31%** apo 5 raste penale,
 - o Agjencioni Pyjor i Kosovës: **0.19%** apo 3 raste penale,
 - o Administrata Tatimore e Kosovës: **0.12%** apo 2 raste penale,
 - o Agjencioni Kosovar i Pronës: **0.06%** apo 1 rast penal.
- PERSONAT: **16.72%** të rasteve penale (I dëmtuari 224 dhe qytetari 80).

Identifikimi dhe zgjidhja e problemit:

PTh.Prishtinë në tri vitet (2013-2015), para hyrjes në fuqi që planit strategjik për ngritjen e efikasitetit në luftimin e Korrupsionit, në regjistrin PP regjistronte mesatarisht në vit 79% të rasteve penale, ndërsa në regjistrin PPN regjistronte mesatarisht 21% të rasteve penale.

PTh.Prishtinë përgjatë gjashtë (6) viteve (2016-2021), gjatë periudhës së funksionimit të planit strategjik për ngritjen e efikasitetit në luftimin e Korrupsionit, në regjistrin PP ka regjistruar mesatarisht në vit 39% të rasteve penale, ndërsa në regjistrin PPN ka regjistruar mesatarisht 61% të rasteve penale.

Që nga viti 2016, dmth që nga fillimi i zbatimit të planit strategjik në PTh.Prishtinë ka ndodhur një ndryshim i madh në kontekst të regjistrimit të rasteve të korrupsionit, sepse më shumë raste të korrupsionit regjistroheshin në regjistrin PPN se sa në regjistrin PP. Për më tej, prokurorët e NJËSIT-it për pesë vite kanë arritur normën në kuotën e përbashkët prej 17.94% (*shih figurën 60*). Mos realizimi i normës orientuese mund të jetë edhe si pasojë e numrit të lartë të regjistrimit të rasteve në regjistrin PPN për faktin se prokurori duhet të kryej tetë (8) raste PPN për t'iu numëruar një (1) rast PP.

Mbi këto fakte KPK-ja në bazë të kërkesës së Kryeprokurorit të PTh.Prishtinë ka ndryshuar udhëzimin Administrativ për normën orientuese vetëm për prokurorët e NJËSIT-it, duke përcaktuar se norma mujore nga gjashtë (6) raste të kryera për DKR, është ulur në katër (4) vetëm për këta prokurorë të NJËSIT-it.

Për më tej, Kryeprokurori i PTh.Prishtinë në kërkesën e njëjtë kishte parashtruar edhe kërkesën për stimulim financiar mujor për prokurorët e NJËSIT-it të PTh.Prishtinë.

Gjashtë prokurorët e DKR-së në NJËSIT, për 5 vite (2016-2020)²⁷ kanë proceduar 643 raste PP dhe 1306 raste PPN, të Korrupsionit, të cilat sipas Udhëzuesit për normë (8 PPN=1 PP), llogariten të jenë kryer 164 raste PP, që rezulton se në total 6 prokurorë për 5 vite kanë kryer 807 raste PP (643+164). Sipas Udhëzuesit për normë (1 prokuror në DKR duhet të kryej 66 raste PP në vit), rezulton se 6 prokurorë për 5 vite do duhej të kryenin **1980** raste PP, gjersa ata kanë kryer **807** raste PP, që rezulton me arritjen e kuotën pesë (5) vjeçare prej **40.76%**, për rastet e Korrupsionit.

Tre prokurorët e DP-së në NJËSIT, për 5 vite (2016-2020) kanë proceduar 224 raste PP dhe 22 raste PPN të cilat sipas Udhëzuesit për normë (8 PPN=1 PP), llogariten të jenë kryer 5 raste PP, që rezulton se në total 3 prokurorë për 5 vite kanë kryer 229 raste PP. Sipas udhëzuesit për normë (1 prokuror në DP duhet të kryej 253 raste PP ne vit), rezulton se 3 prokurorë për 5 vite do duhej të kryenin **3795** raste PP, gjersa ata kanë kryer **229** raste PP, që rezulton me arritjen e kuotës pesë (5) vjeçare prej **6.03%** për rastet e Korrupsionit.

²⁷ Për vitin 2021 nuk mund të realizohet ndonjë analizë për Njësitin lidhur me rastet e korrupsionit, për shkak se Njësitit është destrukturuar për faktin se prokurorët e DP-së janë larguar nga Njësitit dhe lëndët e korrupsionit trajtohen nga të gjithë prokurorët e DKR-së.

Si përfundim, Prokurorët e Njësitit (6 në DKR dhe 3 në DP) në PTh.Prishtinë, në pajtim me udhëzuesin për normë për pesë (5) vite do duhej të kryente 5775 (DKR-1980 dhe DP-3795) raste, ndërsa kanë kryer 1036 raste (DKR-807 dhe DP-229), që rezulton me kuotën prej **17.94%** të rasteve të kryera. Andaj, nga këto të dhëna empirike rezulton se performanca pesë (5) vjeçare e Njësitit në PTh.Prishtinë është në kundërshtim me qëllimet e përcaktuara në planin strategjik dhe planin e veprimit për veprat penale të Korrupsionit (*shih figurën 60*)²⁸.

	DKR (6 prokurorë)		DP (3 prokurorë)	
	Rastet e kryera		Rastet e kryera	
	PP	PPN: 8/1	PP	PPN: 8/1
2016	143	153	58	0
2017	155	290	59	10
2018	127	325	48	1
2019	127	346	37	10
2020	91	192	22	0
	643	1306 : 8=164	224	21 : 8= 5
	643+164 = 807 : 1980 = 40.76%		224+5=229 : 3795 = 6.03%	
Një (1) prokuror në DKR në vit duhet të kryejë 66 raste, ndërsa në 5 vite 330 raste. Gjashtë (6) prokurorë në DKR në vit duhet të kryejnë 396 raste, ndërsa për 5 vite 1980 raste.			Një (1) prokuror në DP në vit duhet të kryejë 253 raste, ndërsa në 5 vite 1265 raste. Tre (3) prokurorë në DP në vit duhet të kryejnë 759 raste, ndërsa në 5 vite 3795 raste	
Njësi për 5 vite ka kryer 1036 raste (DKR-807+DP-229), ndërsa sipas udhëzuesit për normë për 5 vite do duhej të kryeshin 5775 (DKR-1980+ DP-3795). Këto të dhëna dëshmojnë se Njësi për 5 vite ka arritur të kryej vetëm 17.94% të rasteve të Korrupsionit (1036/5775=17.94%).				

Figura 60

Shikuar nga aspekti numerik, të dhënat faktojnë gjendjen reale të arritshmërisë së normës së prokurorëve të Njësitit për periudhën pesë vjeçare, mirëpo të gjitha këto të dhëna janë prezantuar në KPK nga komisioni ad-hoc mbikqyrës në baza tre (3) mujore dhe përgjatë periudhës 5 vjeçare nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë për përmirësim e gjendjes, mirëpo përkundrazi, kryeprokurori i PTh.Prishtinë ka parashtruar në KPK, kërkesën për zvogëlimin e normës për prokurorët e Njësitit si dhe kërkesën për stimulimin financiar për këta prokurorë. Këshilli e ka miratuar kërkesën e parë dhe e ka ndryshuar Udhëzimin për normë, duke përcaktuar se për prokurorët e njësitit norma mujore është 4 raste (*nga 6 sa ishte*), ndërsa nuk e ka miratuar kërkesën për stimulim financiar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të analizës së ofruar në këtë raport ka tri (3) alternativa për trajtimin e rasteve penale të Korrupsionit nga prokurorët e Njësitit në PTh.Prishtinë:

1. Të shuaj Njësitin, për shkak të performancës së dobët.
2. Të gjitha rastet e Korrupsionit të regjistrohen në regjistrin PP.
3. Të bëhet profilizimi i shkallëzuar në Njësitin e PTh.Prishtinë. Profilizimi i shkallëzuar nënkupton që prokurorët e Njësitit të trajtojnë lëndët nga 3 kapituj të veprave penale nga Kodi Penal, *shembull*:
 - Profilizim parësor**: trajtimi i lëndëve të Korrupsionit (**50% të lëndëve nga 100 % e normës**),
 - Profilizim dytësor**: trajtimi i lëndëve nga një kapitulli tjetër i veprave penale (**30%**),
 - Profilizimi tretësor**: trajtimi i lëndëve nga një kapitulli, i tretë, i veprave penale (**20%**).

²⁸ Të gjitha të dhënat statistikore për trajnimin e veprave penale të Korrupsionit në Njësitin e PTh.Prishtinë janë marrë nga raportet vjetore të Komisionit Ad-hoc Mbikqyrës dhe të miratuar në KPK.

4.9 REGJISTRIMI I RASTEVE PENALE NË PTH. PEJË: PP - PPN

Përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021) PTh.Pejë nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale ka pranuar 2896 raste penale, prej të cilave në regjistrin PP ka regjistruar 1510 apo 52%, ndërsa në regjistrin PPN 1386 apo 48% (shih figurën 61).

Raste penale		Regjistri PP	Regjistri PPN
A	1007		
DR	7	808 (80%)	199 (20%)
KM	1	5 (71%)	2 (29%)
KO	920		1 (100%)
KORR	46	369 (40%)	551 (60%)
SHP	903		
TNJ	11	34 (74%)	12 (26%)
E	1007	283 (31%)	620 (69%)
NU	7	11 (100%)	
	2896	1510 (52%)	1386 (48%)

Figura 61

PTh.Pejë në regjistrin PPN ka regjistruar më shumë raste penale se në regjistrin PP për veprat penale Korrupsionit dhe të Krimeve ekonomike, andaj në vijim do të trajtojmë këto grupe.

4.9.1 KORRUPSIONI

PTh.Pejë nga viti 2013 deri në vitin 2021 nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale ka pranuar 920 kallëzime penale me 1557 persona për veprat penale të Korrupsionit, të cilat sipas regjistrave ka regjistruar si në vijim (shih figurën 62).

- Regjistri PPN: **60%** apo 551 raste penale,
- Regjistri PP: **40%** apo 369 raste penale.

KORR	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	#
PP	66 (55%)	45 (65%)	45 (50%)	61 (65%)	38 (35%)	24 (31%)	19 (18%)	36 (32%)	35 (29%)	369 (40%)
PPN	55 (45%)	24 (35%)	45 (50%)	53 (35%)	72 (65%)	53 (69%)	87 (82%)	76 (68%)	86 (71%)	551 (60%)
#	121	69	90	114	110	77	106	112	121	920

Figura 62

PTh.Pejë përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021), në regjistrin PPN ka regjistruar 551 raste penale të Korrupsionit, të cilat sipas subjekteve janë parashtruar nga:

- INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA: **81%** apo 445 raste penale, NJIF-i me 20% apo 112 raste penale, IPK-ja me 7% apo 38 raste penale, EPK me 4% apo 20 raste penale, ndërsa subjektet tjera me më pak 4 e më pak raste penale.
- PERSONAT: kanë parashtruar **19%** apo 106 raste penale (1 dëmtuari-21 dhe qytetari-85)

Identifikimi dhe zgjidhja e problemit:

Konstatohet se PTh.Pejë pas hyrjes në fuqi të planit strategjik për rritjen e efikasitetit në luftimin e Korrupsionit ka regjistruar më shumë raste penale të Korrupsionit në regjistrin PPN. Për më tej, Hipoteza se në regjistrin PPN regjistrohen rastet penale të parashtruara nga qytetarët e të cilat kanë mungesë të informacioneve, nuk qëndron për faktin se qytetarët kanë parashtruar vetëm 19% të rasteve penale të Korrupsionit cilat në prokurori janë regjistruar në regjistrin PPN. Andaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës së bashku me Kryeprokurorin e PTh.Pejë duhet të vendosin që kallëzimet për Korrupsion të regjistrohen vetëm në regjistrin PP.

4.9.2 KRIMET EKONOMIKE : PP - PPN

PTh.Pejë përgjatë tetë (8) viteve; 2014-2021 nga subjektet parashtruese të kallëzimeve penale ka pranuar 903 raste penale për veprat penale të Krimeve ekonomike, të cilat, sipas regjistrave i ka regjistruar si në vijim (*shih figurën 63*).

- Regjistri **PPN**: **69%** apo 620 raste penale.
- Regjistri **PP**: **31%** apo 283 raste penale.

E	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	#
PP	28 (74%)	22 (31%)	32 (49%)	40 (39%)	25 (16%)	48 (20%)	43 (41%)	45 (37%)	283 (31%)
PPN	10 (26%)	48 (69%)	33 (51%)	63 (61%)	130 (84%)	197 (80%)	63 (59%)	76 (63%)	620 (69%)
#	38	70	64	103	155	245	106	121	903

Figura 63

PTh.Pejë gjatë viteve 2014-2021 në regjistrin PPN ka regjistruar 620 raste penale të Krimeve ekonomike të cilat sipas subjekteve janë parashtruar si në vijim:

- INSTITUCIONET E SPECIALIZUARA: kanë parashtruar **99.84%** apo 619 raste, prej tyre:
 - Dogana ka parashtruar 2.74% apo 17 raste penale,
 - E pranuar në kompetencë 0.65% apo 4 raste penale,
 - Policia ka parashtruar 96.45% apo 598 raste penale,
- PERSONAT: qytetari ka parashtruar **0.16%** apo 1 rast penal.

Identifikimi dhe zgjidhja e problemit:

PTh.Pejë, përveç në vitin 2014, më shumë raste penale të Krimeve ekonomike ka regjistruar në regjistrin PPN në raport me regjistrin PP.

Hipoteza se rastet penale të Krimeve ekonomike të regjistruara në regjistrin PPN janë parashtruar nga qytetarët dhe si të tilla kanë mungesë të informacioneve rezulton e pavërtetuar për faktin se 99.84% të rasteve penale të Krimeve ekonomike të parashtruara përgjatë viteve 2014-2021 janë parashtruar nga Institucionet e specializuara, prej tyre 96.45% i përkasin Policisë së Kosovës.

Theksojmë se periudha e regjistrimit të më shumë rasteve penale të Krimeve ekonomike në regjistrin PPN në raport me regjistrin PP, koïncidon me periudhën kohore të planit strategjik për ngritjen e efikasitetit në luftimin e Krimeve ekonomike 2016-2021.

Andaj, Këshilli Prokurorial i Kosovës së bashku me Kryeprokurorin e PTh.Pejë duhet të vendosin që kallëzimet për Krime ekonomike të regjistrohen vetëm në regjistrin PP.

5. PËRFUNDIME

5.1 KONSTATIME

Të gjitha konstatimet në vijim i referohen veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional dhe periudhës nëntë (9) vjeçare (2013-2021).

1. Organet publike kanë parashtruar 91%, ndërsa qytetarët 9% të rasteve penale, prej tyre:
 - a. 76% janë regjistruar në regjistrin PP,
 - b. 24% janë regjistruar në regjistrin PPN.
2. Nga tërësia e rasteve penale, sipas llojit të veprës penale janë regjistruar si në vijim:
 - Tre nga katër raste (3-4) të Shpërlarjes së parasë janë regjistruar PPN,
 - Çdo i dyti (1-2) rast i Korrupsionit është regjistruar PPN,
 - Çdo i treti (1-3) rast i Krimit të organizuar është regjistruar PPN,
 - Çdo i katërti (1-4) rast i Krimeve ekonomike është regjistruar PPN,
 - Çdo shtati (7) rast i Kontrabandës me migrant është regjistruar në regjistrin PPN,
 - Çdo i teti (8) rast i Trafikimit me njerëz është regjistruar në regjistrin PPN,
 - Çdo i njëzet e një (21) rast i Armëve është regjistruar në regjistrin PPN,
 - Çdo i tridhjeti (30) rast i Drogave është regjistruar në regjistrin PPN,
 - Asnjë rast (0) i Nxitjes së urrejtjes nuk është regjistruar në regjistrin PPN.
3. 94% të rasteve penale të regjistruara në regjistrin PP janë parashtruar nga organet publike ndërsa, 6% të rasteve penale janë parashtruar nga qytetarët,
4. Janë proceduar (*kryer/zgjidhur*) 91% të rasteve penale në raport me numrin e rasteve penale të pranuar,
5. PTh.Prizren me 100.60% është prokuroria e vetme që ka proceduar më shumë raste në raport me numrin e rasteve të pranuar,
6. Në fund të vitit 2021 ngarkesa me raste penale është rritur për 13% në raport me vitin 2020, ndërsa 15% në raport me vitin 2019.
7. Në fund të vitit 2021, 73% të ngarkesës me raste penale i përkasin vetëm dy prokurorive: PTh.Prishtinë me 46.36% dhe PTh.Mitrovicë me 26.17% të ngarkesës me lëndë.
8. Janë proceduar (*kryer/zgjidhur*) 93% të personave në raport me numrin e rasteve të pranuar për persona.
9. PSRK me 109.80% dhe PTh.Prizren me 101.60% janë dy prokuroritë e vetme që kanë proceduar më shumë persona në raport me numrin e personave të pranuar.
10. Në fund të vitit 2021 ngarkesa persona është rritur për 12% në raport me vitin 2020, ndërsa 15% në raport me vitin 2019.

11. Në fund të vitit 2021, 81% të ngarkesës me persona i përket vetëm tri prokurorive: PTh.Prishtinë me 37.75%, PTh.Mitrovicë me 22.31% dhe PSRK me 19.34% të totalit.
12. Numri më i ulët i veprimeve/vendimeve prokuroriale është bërë në dy vitet e fundit (2020 dhe 2021), përgjatë periudhës 2013-2021,
13. Gjykatat kanë aprovuar 48% të kërkesave për caktimin e paraburgimit,
14. Nga tërësia e personave të proceduar, për 64% të personave janë ngritur aktakuza, për 35.52% të personave janë hudhur kallëzimet penale apo janë pushuar hetimet dhe për 0.96% të personave janë proceduar në mënyra tjera.
15. PSRK është prokuroria e vetme që mbi gjysmën e rasteve (52% apo 1330) për persona e ka proceduar me hudhje të kallëzimit penal apo pushim të hetimit, në raport me aktakuzat e ngritura apo mënyrat tjera të procedimit (47% apo 1177 persona).
16. Korrupsioni me 60% dhe Shpërlarja e parasë me 70% janë grupet e vetme që kanë nivelin mbi gjysmën e rasteve të proceduara me hudhje të kallëzimit penal apo pushimit të hetimit për persona, në raport me aktakuzat e ngritura për persona.
17. Disa prokurori kanë regjistruar dhe proceduar rastet e personave të përfshirë në veprat penale të cilat janë në kompetencë ekskluzive të PSRK-së. PTh.Prishtinë ka regjistruar 4 persona për Krim të organizuar. PTh.Prizren ka hudhur kallëzimin penal për një person për Krim të organizuar dhe për 3 persona për Shpërlarje të parasë, ndërsa për 13 persona për Krim të organizuar ka ngritur aktakuzë. PTh.Ferizaj ka ngritur aktakuzë për 2 persona për Krim të organizuar.
18. Gjykatat kanë shpallur fajtor 26% të personave të akuzuar, sipas prokurorive:
 - PTh.Prizren: 64%
 - PTh.Ferizaj: 51%
 - PTh.Pejë: 38%
 - PTh.Gjakovë: 27%
 - PTh.Mitrovicë: 12%
 - PSRK: 9%
 - PTh.Gjilan 7%
 - PTh.Prishtinë: 7%
19. Gjykatat kanë shpallur fajtor 26% të personave të akuzuar, sipas veprave penale:
 - Drogat: 31%
 - Kontrabandimi me migrant: 31%
 - Armët: 27%
 - Korrupsioni: 22%
 - Krimet ekonomike: 20%
 - Trafikimi me njerëz: 17%
 - Nxitja urrejtjes: 16%
 - Shpërlarja e parasë: 11%
 - Krimi organizuar: 6%

20. Gjykata e Apelit ka aprovuar 8% të ankesave mbi dënimin apo arsyet tjera, prej tyre Korrupsioni me 9% rezulton të ketë nivelin më të lartë të aprovimit sipas veprave penale, ndërsa sipas prokurorisë rezulton se PTh.Prizren me 13% të ankesave të aprovuara.
21. Nivelin mbi 50% të hudhjes së kallëzimeve penale apo pushimit të hetimeve ndaj personave rezulton të kenë veprat penale nëpër prokuroritë si në vijim:
- Shpërlarja e parasë: 69% në PSRK,
 - Korrupsioni: 65% Prishtinë dhe Pejë, 59% Prizren dhe Gjilan.
 - Krimet ekonomike: 65% Mitrovicë dhe 55% Prizren.
 - Trafikimi me njerëz: 50% në Pejë.
22. Dy (2) prokurori kanë proceduar më shumë persona në raport me numrin e personave të pranuar:2013-2021.
- PSRK me 110%, sepse ka pranuar 2329 ndërsa ka proceduar 2558 persona.
 - PTh.Prizren me 102% sepse ka pranuar 4047 ndërsa ka proceduar 4110 persona.
23. Nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura ndaj personave rezulton të ketë Th.Ferizaj me 78%, nga numri i përgjithshëm i rasteve të proceduara për persona.
24. PSRK ka proceduar rastet e 2558 personave, prej tyre për 52% ka hudhur kallëzimin penal apo pushuar hetimin, për 46% ka ngritur aktakuza, ndërsa 2% në mënyrë tjetër.
25. PTh.Prishtinë ka proceduar 7624 persona, prej tyre për 59% ka ngritur aktakuza, për 41% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimin, ndërsa 0.6% në mënyrë tjetër.
26. PTh.Prizren ka proceduar 4110 persona, prej tyre për 61% ka ngritur aktakuza, për 36% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimet, ndërsa 2% në mënyrë tjetër.
27. PTh.Pejë ka proceduar 2037 persona, prej tyre për 65% ka ngritur aktakuza, për 35% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimin, ndërsa 0.5% në mënyrë tjetër.
28. PTh.Gjilan ka proceduar 2484 persona, prej tyre për 73% ka ngritur aktakuza, për 26% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimin, ndërsa 0.1% në mënyrë tjetër.
29. PTh.Mitrovicë ka proceduar 2104 persona, prej tyre prej tyre për 72% ka ngritur aktakuza, për 27% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimin, ndërsa 0.5% në mënyrë tjetër.
30. PTh.Ferizaj ka proceduar 2432 persona, prej tyre prej tyre për 78% ka ngritur aktakuza, për 21% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimin, ndërsa 0.7% në mënyrë tjetër.
31. PTh.Gjakovë ka proceduar 1225 persona, prej tyre prej tyre për 71% ka ngritur aktakuza, për 228% ka hudhur kallëzimin penal apo ka pushuar hetimin, ndërsa 0.9% në mënyrë tjetër.

32. 81% të rasteve penale të regjistruara në regjistrin PPN janë parashtruar nga organet publike ndërsa, 19% të rasteve penale janë parashtruar nga qytetarët,
33. Janë mbyllur 88% të rasteve PPN në raport me numrin e rasteve të regjistruara PPN,
34. Nivelin më të lartë të mbylljes së rasteve sipas veprave penale rezulton të kenë Krimet ekonomike me 91% në raport me rastet e regjistruara PPN.
35. Nivelin më të lartë të mbylljes së rasteve sipas prokurorisë rezulton të ketë PTh.Prizren me 99.76% në raport me numrin e rasteve të regjistruara PPN.
36. Në fund të vitit 2021 ngarkesa me raste penale PPN është rritur për 12% në raport me vitin 2020, ndërsa 13% në raport me vitin 2019.
37. Në fund të vitit 2021, 77% të ngarkesës me raste penale PPN i përkasin vetëm tri prokurorive: PTh.Prishtinë me 49%, PSRK me 17% dhe PTh.Pejë me 11%,
38. Në fund të vitit 2021, sipas llojit të veprës penale nivelin më të lartë të ngarkesës rezulton të ketë: Korrupsioni me 71%, pastaj Krimet ekonomike me 15% dhe të tjerat me përqindje njëshifrore.
39. Janë mbyllur rastet PPN për 86% të personave në raport me numrin e personave në rastet e regjistruara PPN.
40. Në fund të vitit 2021 ngarkesa me persona në rastet penale PPN është rritur për 22% në raport me vitin 2020, ndërsa 15% në raport me vitin 2019.
41. Në fund të vitit 2021, 77% të ngarkesës me raste penale PPN i përkasin vetëm tri prokurorive: PTh.Prishtinë me 39%, PSRK me 26% dhe PTh.Pejë me 12%.
42. Në fund të vitit 2021, sipas llojit të veprës penale nivelin më të lartë të ngarkesës rezulton të ketë: Korrupsioni me 69%, pastaj Krimet ekonomike me 11% dhe të tjerat me përqindje njëshifrore.
43. Në fund të vitit 2021, nga tërësia e ngarkesës me raste penale nga regjistrin PP dhe PPN, nivelin më të lartë të ngarkesës sipas prokurorive rezulton të ketë PTh.Prishtinë me 47.30% të rasteve penale (PP dhe PPN), ndërsa PTh.Gjilan me 1.29% nivelin më të ulët.
44. Në fund të vitit 2021, nga tërësia e ngarkesës me raste penale nga regjistri PP dhe PPN, 71% të ngarkesës e përbëjnë vetëm dy grupe të veprave penale: Korrupsionit me 35.70% dhe Drogave me 35.30%. Në PSRK 74% të ngarkesës me raste PP dhe PPN e përbëjnë vetëm dy grupe të veprave penale: Korrupsioni me 43% dhe Shpërlarja e parasë me 31%.
45. Mbi 70% të rasteve penale të pranuar janë regjistruar në regjistrin PPN, si në vijim:
 - a. PSRK: 73% të rasteve të Shpërlarjes së parasë.
46. Mbi 60% të rasteve penale të pranuar janë regjistruar në regjistrin PPN, si në vijim:

- a. PTh.Pejë: 69% të rasteve penale të Krimeve ekonomike.
 - b. PTh.Pejë: 60% të rasteve penale të Korrupsionit.
47. Mbi 50% të rasteve penale të pranuar janë regjistruar në regjistrin PPN, si në vijim:
- a. PSRK: 57% të rasteve penale të Korrupsionit.
 - b. PTh.Prishtinë: 53% të rasteve penale të Korrupsionit.
48. Mbi 40% të rasteve penale të pranuar janë regjistruar në regjistrin PPN, si në vijim:
- a. PSRK: 43% të rasteve penale të Trafikimit me njerëz.
 - b. PSRK: 47% të rasteve penale të Krimeve ekonomike.
 - c. PTh.Prizren: 47% të rasteve penale të Korrupsionit.
 - d. PTh.Ferizaj: 42% të rasteve penale të Korrupsionit.
49. Mbi 30% të rasteve penale të pranuar janë regjistruar në regjistrin PPN, si në vijim:
- a. PSRK: 31% të rasteve penale të Kontrabandës me migrant.
 - b. PSRK: 30% të rasteve penale të Krimin të organizuar.
 - c. PTh.Ferizaj: 30% të rasteve penale të Kontrabandës me migrant.
50. Mbi 20% të rasteve penale të pranuar janë regjistruar në regjistrin PPN, si në vijim:
- a. Prishtinë: 23% të rasteve penale të Krimeve ekonomike.
 - b. PTh.Pejë: 20% të rasteve penale të Drogave.
 - c. PTh.Pejë: 29% të rasteve penale të Kontrabandës me migrant.
 - d. PTh.Gjilan: 24% të rasteve penale të Korrupsionit.
 - e. PTh.Mitrovicë: 21% të rasteve penale të Kontrabandës me migrant.
 - f. PTh.Mitrovicë: 24% të rasteve penale të Kontrabandës me migrant.
 - g. PTh.Ferizaj: 26% të rasteve penale të Trafikimit me njerëz.
51. Në regjistrin PPN janë regjistruar 24% apo 5306 të rasteve penale, prej tyre sipas grupi të veprave penale i përkasin grupeve si në vijim:
- a. Korrupsion: 62% apo 3290 raste penale,
 - b. Krimet ekonomike: 26% apo 1376 raste penale,
 - c. Drogat: 5% apo 267 raste penale,
 - d. Shpërlarja e parasë: 4% apo 235 raste penale,
 - e. Krimi organizuar: 1% apo 50 raste penale,
 - f. Trafikimi me njerëz: 0.83% apo 44 raste penale,
 - g. Kontrabanda me migrant: 0.72% apo 38 raste penale,
 - h. Armët: 0.11% apo 6 raste penale.
52. Në regjistrin PPN janë regjistruar 24% apo 5306 të rasteve penale, të cilat i përkasin prokurorive si në vijim:
- a. PTh.Prishtinë: 37% apo 1938 raste penale,
 - b. PTh.Pejë: 26% apo 1386 raste penale,
 - c. PSRK: 12% apo 614 raste penale,
 - d. PTh.Ferizaj: 9% apo 502 raste penale,
 - e. PTh.Gjakovë: 3% apo 154 raste penale,
 - f. PTh.Gjilan: 2% apo 126 raste penale,
 - g. PTh.Mitrovicë: 2% apo 121 raste penale.

53. Në regjistrin PPN (2013-2021) janë regjistruar 3290 raste penale të Korrupsionit, të cilas i përkasin prokurorive si në vijim:
- | | |
|-------------------|-------------------------------|
| a. PTh.Prishtinë: | 49.21% apo 1619 raste penale, |
| b. PTh.Pejë: | 16.75% apo 551 raste penale, |
| c. PSRK: | 9.60% apo 316 raste penale, |
| d. PTh.Prizren: | 9.45% apo 311 raste penale, |
| e. PTh.Ferizaj: | 5.44% apo 179 raste penale, |
| f. PTh.Gjakovë: | 4.35% apo 143 raste penale, |
| g. PTh.Mitrovicë: | 3.10% apo 102 raste penale, |
| h. PTh.Gjilan: | 2.10% apo 69 raste penale. |
54. PSRK në regjistrin PPN ka regjistruar numër më të lartë të rasteve penale të Korrupsionit (59%) dhe Shpërlarjes së parasë (73%) , në raport me rastet e regjistruara në regjistrin PP. Në dy vitet e fundit 2020 dhe 2021, në regjistrin PP është regjistruar numër më të lartë të raste penale të Korrupsionit në dy vitet e fundit 67% në vitin 2019 dhe 69% në vitin 2020, që është si rezultat i udhëheqjes së re në PSRK.
55. PTh.Prishtinë përgjatë nëntë (9) viteve (2013-2021) në regjistrin PPN ka regjistruar 1938 raste penale, 84% prej tyre i përkasin Korrupsionit. Nga tërësia e rasteve penale të pranuar të Korrupsionit, 53% janë regjistruar në regjistrin PPN ndërsa, 47% në regjistrin PP.
56. PTh.Prishtinë në tri vitet (2013-2015), para hyrjes në fuqi që planit strategjik për ngritjen e efikasitetit në luftimin e Korrupsionit, në regjistrin PP regjistronte mesatarisht në vit 79% të rasteve penale, ndërsa në regjistrin PP regjistronte mesatarisht 21% të rasteve penale.
57. PTh.Prishtinë përgjatë gjashtë (6) viteve (2016-2021), gjatë periudhës së funksionimit të planit strategjik për ngritjen e efikasitetit në luftimin e Korrupsionit, në regjistrin PP ka regjistruar mesatarisht në vit 39% të rasteve penale, ndërsa në regjistrin PPN ka regjistruar mesatarisht 61% të rasteve penale.
58. Që nga viti 2016, dmth që nga fillimi i zbatimit të planit strategjik në PTh.Prishtinë ka ndodhur një ndryshim i madh në kontekst të regjistrimit të rasteve të korrupsionit, sepse më shumë raste të korrupsionit regjistroheshin në regjistrin PPN se sa në regjistrin PP. Për më tej, prokurorët e NJËSIT-it për pesë vite kanë arritur normën në kuotën e përbashkët prej 17.94%. Mos realizimi i normës orientuese mund të jetë edhe si pasojë e numrit të lartë të regjistrimit të rasteve në regjistrin PPN për faktin se prokurori duhet të kryej tetë (8) raste PPN për t'iu llogaritur si një (1) rast PP i kryer.
59. Gjashtë prokurorët e DKR-së në NJËSIT, për 5 vite (2016-2020) kanë proceduar 643 raste PP dhe 1306 raste PPN, të Korrupsionit, të cilat sipas Udhëzuesit për normë (8 PPN=1 PP), llogariten të jenë kryer 164 raste PP, që rezulton se në total 6 prokurorë për 5 vite kanë kryer 807 raste PP (643+164). Sipas Udhëzuesit për normë (1 prokuror në DKR duhet të kryej 66 raste PP në vit), rezulton se 6 prokurorë për 5 vite do duhej të kryenin

1980 raste PP, gjersa ata kanë kryer 807 raste PP, që rezulton me arritjen e kuotën pesë (5) vjeçare prej 40.76%, për rastet e Korrupsionit.

60. Tre prokurorët e DP-së në NJËSIT, për 5 vite (2016-2020) kanë proceduar 224 raste PP dhe 22 raste PPN të cilat sipas Udhëzuesit për normë (8 PPN=1 PP), llogariten të jenë kryer 5 raste PP, që rezulton se në total 3 prokurorë për 5 vite kanë kryer 229 raste PP. Sipas udhëzuesit për normë (1 prokuror në DP duhet të kryej 253 raste PP ne vit), rezulton se 3 prokurorë për 5 vite do duhej të kryenin 3795 raste PP, gjersa ata kanë kryer 229 raste PP, që rezulton me arritjen e kuotës pesë (5) vjeçare prej 6.03% për rastet e Korrupsionit.
61. PTh.Pejë në regjistrin PPN ka regjistruar numër më të lartë të rasteve penale të Krimeve ekonomike (69%) dhe Korrupsionit (60%), në raport me rastet e regjistruara në regjistrin PP. Theksojmë se periudha e regjistrimit të më shumë rasteve penale të Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike në regjistrin PPN në raport me regjistrin PP, koïncidon me periudhën kohore të planit strategjik për ngritjen e efikasitetit në luftimin e Krimeve ekonomike 2016-2021.

5.2 REKOMANDIME

Rekomandimi	1
Të largohet nga përdorimi si subjekt parashtrues i kallëzimeve penale “E pranuar në kompetencë”, për faktin se subjektet parashtruese të kallëzimeve janë të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në mesin e atyre subjekteve nuk është “E pranuar në Kompetencë”.	
Arsyetimi:	Regjistrimi i kallëzimeve penale të reja nën emrin e subjektit “E pranuar në kompetencë”, ka bërë rritje artificiale të rasteve. Kjo për shkak se rasti fillimisht është parashtruar nga njëri prej subjekteve parashtruese të kallëzimeve penale të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale, pastaj është regjistruar për here të dytë, si rast i parashtruar nga “E pranuar në kompetencë”. Kjo praktikë për pasojë ka rritur artificialisht numrin e rasteve dhe personave të përfshirë në veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, përmes raporteve statistikore, analistiko-krahasimore dhe raportit gjeografia e krimin.
Procedura:	Vendimi i Këshillit për largimin “E pranuar në kompetencë” nga lista e subjekteve parashtruese të kallëzimeve penale të fillojë zbatueshmërinë nga 01 janar 2023, respektivisht vendimi i adresohet vetëm rasteve penale të pranuar të reja, ndërsa për zbatimin e vendimit të obligohen: <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyra e statistikave në NJSHP, 2. Të gjitha prokuroritë themelore, 3. Prokuroria Speciale., 4. Koordinatorin Nacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional.

Rekomandimi	2
<p>Nga grupi i Drogave të largohen katër (4) nga tetë (8) veprave penale të grupit të Drogave, për faktin se këto vepra penale nuk përmbajnë elementin e “Trafikimit” si kushtin bazë për përfshirjen e një vepre penale në kuadër të klasifikimit dhe kategorizimit të veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional. Veprat penale që duhet të largohen nga grupi i Drogave janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 i KPRK-së. 2. Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269, 3. Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope, nga neni 270, 4. Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 271. 	
Arsyetimi:	
<p>Elementi i trafikimit ka qenë kushti bazë për përfshirjen e një vepre penale në kuadër grupit të armëve, drogave dhe trafikimit me njerëz të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional. Mbi këtë parim në grupin e Armëve është përfshirë vetëm një vepër penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” nga neni 364 i KPRK-së, ndërsa veprat tjera penale të Kapitullit të Armëve nga KPRK nuk janë përfshirë.</p> <p>Meqenëse, në grupin e Drogave ishin përfshirë shumë vepra penale, gjysma prej tyre nuk përmbanin elementin e “Trafikimit”, për pasojë ky grup me rreth 50%, është bërë grupi më ngarkesën më të madhe të rasteve penale nga tërësia rasteve penale për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, ndërsa katër veprat penale pa elementin e “trafikimit” përbëjnë rreth 80% të tërësisë së veprave penale të Drogave. Në raportet periodike “Gjeografia e krimit” shpërfaqet pasoja e 4 veprave penale pa elementin e “trafikimit”, në grupin e Drogave, për faktin se në hartat me ndarje rajonale Drogat, si të vetme, përbëjnë grupin me nivelin më të lartë veprave penale në nivel rajoni dhe vendi.</p> <p>Me largimin e katër veprave penale të cilat nuk përmbajnë elementin e trafikimit në grupin e Drogave do të mbesin 4 vepra penale të cilat përbajnë elementin e “Trafikimit”, si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike, nga neni 268 të KPRK-së. 2. Kultivimi i bimës së hashashit, shkurreve të kokainës ose bimëve të kanabisit, nga neni 272 3. Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope, nga neni 273, 4. Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull, nga neni 274. 	
Procedura	
<p>Vendimi i Këshillit për largimin e katër veprave penale, nga neni 267, 270, 271 dhe 272 nga grupi i Drogave, të fillojë nga 1 janar 2023, vetëm për kallëzimet e reja penale, ndërsa për zbatimin e vendimit të obligohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyra e statistikave në NJSHPP, 2. Të gjitha prokuroritë themelore, 3. Prokuroria Speciale. 4. Koordinatorin Nacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional. 	

Rekomandimi**3**

Këshilli të merr vendim lidhur me Njësitin e PTh.Prishtinë, në mes dy alternativave si në vijim:

1. Të përfundojë funksionimin e Njësitit në PTh.Prishtinë, apo
2. Të bëjë profilizimin tematik sipas shkallshmërisë, sipas rekomandit nr.5.
 - Profilizimi parësor me lëndët e korrupsionit: 50% të normë nga 100% e normës.
 - Profilizimi dytësor me lëndët e krimeve ekonomike: 30% të normës nga 100% e normës.
 - Profilizimi tretësor me lëndët e natyrave tjera në DKR: 20% të normës nga 100% e normës.

Në alternativën nr.2 përfshihet anulimi i U.Administrativ 01/2021 për normën orientuese dhe mbetja në fuqi e U.Administrativ 01/2018 për normën orientuese (*norma me 6 raste të kryera*). Kjo për faktin se prokurorët e DKR-së me këto tri grupe të natyrës së lëndëve mund të kryejnë 6 lëndë në muaj apo 66 lëndë në vit.

Për më tej, në interes të prokurorët të DKR-së në Njësit dhe të sistemit prokurorial, të gjitha kallëzimet penale për veprat penale të Korrupsionit të regjistruhen në një regjistër të vetëm të kallëzimeve penale PP, në pajtim me nenin 80 paragrafi 1 të Kodit Nr.04/-123 i Procedurës Penale apo neni 81 paragrafi 1 të Kodit Nr.08L-032 i Procedurës Penale²⁹ (*Kallëzimi penal i paraqitet prokurorit kompetent të shtetit me shkrim, me mjete teknike të komunikimit ose gojarisht*). Regjistrimi i kallëzimeve penale të Korrupsionit në pajtim me nenin 80, par.1, të KPP Nr.04/-123 apo nenin 81 paragrafi 1 të KPP Nr. 08L-032, mundëson zbatimin e nenit 82 paragrafi 1 të KPP Nr.04/-123 apo nenit 84 par.1 të KPP Nr. 08L-032, (*prokurori i shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal brenda 30 ditëve nëse plotësohet njëri prej kushteve të përcaktuara*), si dhe zbatimin e nenit 84 paragrafi 4 dhe 5 të KPP/Nr. 08L-032, që i referohet të drejtës të dëmtuarit ose viktimës apo personit apo organit që ka parashtruar kallëzimin penal, që pas pranimit të aktvendimit mbi hedhje e kallëzimit penale nga prokurori, të mund të paraqesë ankesë në Apel.

Arsyetimi:

Këshilli në kuadër të planit strategjik për rritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve të Korrupsionit dhe krimeve ekonomike përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, në vitin 2016 ka krijuar Njësitin në PTh.Prishtinë për trajtimin ekskluzivisht të lëndëve të këtyre si dhe komisionin Ad-hoc, mbikqyrës për zbatimin e planit strategjik dhe raportimin periodik në Këshill. Të dhënat dhe raportet e Komisionit kanë faktuar se Njësi (DKR dhe DP) për gjashtë vite (2016-2020)³⁰ ka arritur të kryejë 17.94% të normës orientuese sipas Udhëzuesit Administrativ 01/2018, respektivisht prokurorët e DKR-së në Njësit kanë arritur të kryejnë 40.76% të normës orientuese, ndërsa prokurorët e DP-së në Njësi kanë arritur të kryejnë 6.03% të normës orientuese.

Me kërkesë të Kryeprokurorit të PTh.Prishtinë, Këshilli me vendim KPK/Nr.128/2021, të dates 25 shkurt 2021, ka shuar DP-në nga Njësi në PTh.Prishtinë, me ç'rast raportet e Komisionit Ad-hoc mbikqyrës kanë mbetur të pa individualizuara në kontekst të arritjes në normës orientuese, ndërsa raportimi individualizuar vazhdon për prokurorët e DKR-së në Njësitin e PTh.Prishtinë.

Në reflektim të nivelit të arritshmërisë së normës orientuese të Njësitit, Këshilli me 02 nëntor 2021 ka miratuar U.A. nr.01/2021 për ndryshim plotësimin e normës orientuese për prokurorët e Njësitit në PTh.Prishtinë, duke ulur normën nga 6 raste të kryera në 4 raste të kryera në muaj, respektivisht 44 lëndë të kryera në vit.

²⁹ Kodi Nr.08L-032 i Procedurës penale është miratuar më, 14 korrik 2022 ndërsa hyn në fuqi gjashtë muaj pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

³⁰ Në mungesë të të dhënave të individualizuara (*statistikave për prokururë*), në këtë analizë nuk është përfshirë viti 2021 për faktin se me vendim të KPK-së Njësi-n e përbëjnë vetëm prokurorët e DKR-së.

Përkundër vendimit të KPK-së për shuarjen e DP-së në Njësitin e PTh.Prishtinë, dhe përndurër uljes së normës nga 6 në 4 raste për Prokurorët e Njësitit në PTh.Prishtinë, në gjashtë muajt e parë të vitit 2022, prokurorët e DKR-së në Njësit kanë kryer vetëm 24% të normës orientuese. Gjashtë prokurorët e Njësitit të do duhej të kryenin 144 raste të Korrupsionit për gjashtë muajt, ndërsa kanë kryer gjithsej 35 raste apo 24% të normës. Në bazë të të dhënave nga Mekanizmi Përcjellës Ndërinstitucional, këta gjashtë prokurorë kanë kryer 25 raste të korrupsionit nga regjistri PP dhe 83 raste të korrupsionit nga regjistri PPN të cilat llogariten 10 raste të kryera PP. Për më tej, sipas U.A me normën prej 4 rasteve të kryera, një prokuror i vetëm do duhet të kryente 24 raste të korrupsionit, ndërsa në rastin konkret 6 prokurorë kanë kryer 35 raste të Korrupsionit.

Një prej arsyeve, të arritshmërisë së normës në nivelet e përshkruara më lartë, të theksuara nga prokurorët e Njësitit, rezulton të jetë edhe aspekti i përlllogaritjes së rasteve të proceduara PPN, respektivisht duhet të kryhen tetë (8) lëndë PPN për t'u llogaritur 1 lëndë e kryer PP. Prokurorët kanë deklaruar se lëndët e Korrupsionit nga regjistri PPN janë të njëjta me lëndët e Korrupsionit nga regjistrin PP në aspektin e material dhe procedural të trajtimit, dhe si të tilla në aspektin e trajtimit kërkohet angazhim i njëjtë dhe marrin kohë të njëjtë me lëndët e Korrupsionit nga regjistri PP.

Këshilli vendos për përzgjedhjen e njëres prej alternativave të përshkruara në rekomandim nr.3. Nëse Këshilli vendor të zgjedhë rekomandimin e parë, atëherë me vendim e shuan Njësitin në PTh.Prishtinë, e abrogon U.A.nr.1/2021 për normën orientuese.

Nëse Këshilli vendos të zgjedhë rekomandimin e dytë, atëherë me vendim përcakton:

1. Prokurorët e DKR-së do të pjesë e Njësitit me profilizim tematik të përshkallëzuar,
2. Abrogon U.A.nr.1/2021 për normën orientuese.
3. Të obligohet të gjitha prokuroritë që rastet penale të Korrupsionit të regjistrojnë PP e jo PPN.

Rekomandimi

4

Në reflektim të dispozitave të Kodit të ri (Nr.08L-032) të Procedurës Penale, respektivisht të drejtës së të dëmtuarit ose viktimës, personit apo organit që ka parashtruar kallëzimin penal për të bërë ankesë në prokurorinë e Apelit ndaj vendimit të prokurorit për hudhjen e kallëzimit penal dhe pushimit të hetimeve, në raportet e Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional duhet të përfshihen edhe të dhënat si në vijim:

1. Parashtruesi i ankesës:
 - Prokuroria konkrete (prokuroria themelore respektive apo PSRK-ja).
 - Palët, pas dështimit të prokurorit të prokurorisë konkrete, që brenda 6 muajve të procedojë ankesën në Apel.
2. Vendimi i prokurorisë së apelit lidhur me ankesat e proceduara nga prokuroria.
 - Numri i ankesave të aprovuara, sipas prokurorisë konkrete,
 - Numri ankesave të refuzuara, sipas prokurorisë konkrete,
3. Vendimi i prokurorisë së apelit lidhur me ankesat e proceduara direkt nga palët.
 - Numri i ankesave të aprovuara, sipas prokurorive konkrete,
 - Numri ankesave të refuzuara, sipas prokurorive konkrete,

Arsyetimi:

Kodi i ri (Nr.08L-032) i Procedurës Penale ka përcaktuar të drejtën e ankesës së palëve ndaj vendimit të prokurorit për hudhjen e kallëzimit penale (neni 84) dhe pushimin e hetimeve (neni 156), andaj këto të dhëna duhet të përfshihen në Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional për

veprat penale karakteristike dhe si të tilla fillimisht të grumbullohen nga NJSHPP dhe të paqyrohen në raportet e Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, për t'u miratuar në Këshill.

Procedura:

Tabela e bashkëngjitur, është e gatshme për miratim nga Këshilli dhe për t'u zbatuar respektivisht për të administruar të dhënat dhe për gjeneruar raporte statistikore nga:

1. Prokuroria e Apelit (për t'i administruar dhe raportuar të dhënat)
2. Zyra e statistikave në NJSHPP (për të grumbulluar të dhënat dhe dërguar tek koordinatori)
3. Koordinatorin nacional të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (për të hartuar raportet)
4. Prokuroritë Themelore dhe PSRK (për t'i raportuar të dhënat në NJSHPP dhe komisione)

Këto të dhëna të prokurorisë së Apelit, duke përfshirë emrin e prokurorit, do t'u shërbejnë:

1. Komisionit për vlerësimin e performancës së prokurorëve (për performancë)
2. Komisionit Ad-Hoc mbikqyrës për rritjen e efikasitetit (për rastet e korrupsionit)
3. Komisioni për Administrimin e Prokurorive (për monitorim të zbatimit të KPP-së),
4. Kryeprokurorëve të prokurorive themelore dhe PSRK-së (për disiplinim)

Me kërkesë të Komisioneve, prokuroria e Apelit obligohet të t'u ofroj të dhënat sipas formularit dhe emrave të prokurorëve të prokurorive respektive (*shih formularin në vijim*).

Për më tej, Kryeprokurori i Apelit duhet të obligohet nga Këshilli që të njoftoj Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse për rastet e dështimit të prokurorëve që brenda 6 muajve të procedojnë në prokurorinë e Apelit ankesat e palëve, e për të cilat raste Apeli është vënë në dijeni nga ankesa e drejtpërdrejtë e palëve në prokurorinë e Apelit.

Formulari apo tabela e ofruar në dispozicion është në faqen në vijim:

Formulari i krijuar në zbatim të normës nga Kodi i ri i Procedurës penale, që adreson të drejtën e ankesës në prokurorinë e Apelit, ndaj vendimit të prokurorit për hudhjen e kallëzimit penale dhe pushimit të hetimeve (*shih figurën 64*).

Kodi Nr.08L-032 i Procedurës Penale									
I dëmtuari ose viktimi, personi apo organi që ka parashtruar kallëzimin penal ka parashtruar ankesë në Prokurorinë e Apelit ndaj vendimit të prokurorit për hudhje të kallëzimit penale apo pushimit të hetimeve.									
Prokuroria	Numri i ankesave	Ankesa e proceduar nga Prokurori në Apel				Ankesa nga parashtruesi i kallëzimit penal ne Apel			
		Hudhje e kallëzimit penal (neni 84 par.5) ³¹		Pushimi hetimit (neni 156 par.8) ³²		Hudhje e kallëzimit penal (neni 84 par.8) ^{33, 34}		Pushimi hetimit (neni 156 par.8) ³⁵	
		Aprovuar	Refuzuar	Aprovuar	Refuzuar	Aprovuar	Refuzuar	Aprovuar	Refuzuar
Prokuroria Apelit									
1	PSRK								
2	PTh.Prishtinë								
3	PTh.Prizren								
4	PTh.Pejë								
5	PTh.Gjilan								
6	PTh.Mitrovicë								
7	PTh.Ferizaj								
8	PTh.Gjakovë								
	<i>Gjithsej:</i>								

Figura 64

³¹ Në qoftë se prokurori i shtetit e ka hedh poshtë kallëzimin penal, i dëmtuari ose viktimi mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni. Ankesa paraqitet në Prokurorinë e Apelit përmes prokurorisë themelore. Ankesa duhet të përmbajë faktet dhe arsyet e ankesës (par.5, neni 84, Kodi Nr.08L-032 të Procedurës Penale).

³² Kur prokurori i shtetit pushon hetimin, i dëmtuari ose viktimi mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për pushimin e hetimit në Prokurorinë e Apelit, përmes prokurorisë themelore. Dispozitat e nenit 84 të këtij Kodi zbatohen përshtatshëmrisht (par. 8, nen 156 të Kodi Nr.08L-032 të Procedurës Penale).

³³ Pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muajsh nga paraqitja e kallëzimit penal apo aktvendimit nga paragrafi 6 i këtij neni, i dëmtuari ose viktimi mund të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Prokurorinë e Apelit për dështimin e prokurorit që të ndërmerr veprime. Procedura e paraparë në paragrafin 6 dhe 7 të këtij neni zbatohet përshtatshëmrisht (par.8, neni 84, Kodi Nr.08L-032 të Procedurës Penale).

³⁴ Në qoftë se Prokuroria e Apelit vlerëson se ankesa është e bazuar, nxjerr aktvendim me të cilin e udhëzon prokurorin e shtetit për ndërmarrjen e veprimeve shtesë lidhur me kallëzimin penal. Parashtruesi i ankesës njoftohet nga Prokuroria e Apelit se ankesa i tij është aprovuar (par.6, neni 84, Kodi Nr.08L-032 të Procedurës Penale).

³⁵ Kur prokurori i shtetit pushon hetimin, i dëmtuari ose viktimi mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për pushimin e hetimit në Prokurorinë e Apelit, përmes prokurorisë themelore. Dispozitat e nenit 84 të këtij Kodi zbatohen përshtatshëmrisht (par.8, neni 156, Kodi Nr.08L-032 të Procedurës Penale)

Rekomandimi 5

Këshilli për zbatimin e objektivit strategjik 2022-2024 respektivisht të realizimit të shtyllës së 3-të “Profilizimi i prokurorëve” të themelohet grup punues me këto detyra:

1. Të bëjë analizën 10 vjeçare të pranimit të veprave penale sipas kapitujve, të nxjerrë mesataren vjetore, parashikimin 10 vjeçar të veprave penale dhe numrin e nevojshëm të prokurorëve, sipas normës orientuese, për çdo departament në 10 vitet e ardhshme.
2. Të hartojë planin strategjik “Profilizimi i prokurorëve” të prokurorive themelore,
3. Të bëjë kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale të Kodit Penal sipas nivlit të dënimit dhe departamenteve të prokurorive themelore,
4. Të bëjë kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale të Kodit Penal sipas modelit të OKB-së.
5. T’i propozojë Këshillit alternativën më të mirë të kategorizimit dhe klasifikimit të veprave penale, në mes alternativës në pikën 3 apo 4 të këtij rekomandimi duke përfshirë parashikimin e nevojshëm të prokurorëve për 10 vite sipas kriterëve të CEPEJ.
6. Të hartojë Rregulloren për profilizimin e prokurorëve të Prokurorive Themelore.

Këshilli në planin strategjik ka parashikuar që profilizimi të realizohet deri në vitin 2024.

Arsyetimi:

Kriminaliteti, aktualisht, është i sofistikuar në kontekst të kryerjes së krimit dhe aftësisë në fshehjen e krimit dhe të gjurmëve. Për më tej, kryesit e këtyre veprave penale, kanë krijuar pasuri të madhe të cilën mund ta përdorin për të paguar shumë mirë mbrojtësit e tyre në rast të zënies së tyre për shkelje të ligjit.

Andaj, aktualisht, është nevojë e kohës që prokurorët të ngrisin nivelin profesional përmes zvogëlimit të kuadrit ligjor të ndjekjes penale, respektivisht prokurorët duhet të profilizohen me qëllim të trajtimit të një grupi të caktuar të veprave penale. Nëse një prokuror do të profilizohet për trajtimin e një grupi të ngushtë të veprave penale, i njëjti prokuror përmes trajnimeve dhe praktikës së punës do të arrijë nivel shumë të lartë të ndjekjes së veprave të tilla penale si dhe rastet e tilla do të përfundojnë me aktgjykime dënuese.

Për të bërë profilizimin e prokurorëve Këshilli duhet të emëroj grupin punues për hartimin e planit strategjik për profilizimin e prokurorëve dhe pastaj hartimin e rregullores për profilizimin e prokurorëve, në mënyrë që në vitin 2024 të funksionalizohet projekti dhe të fillojë zbatimin e rregullores.

Historiku: KPK-ja, me iniciativë të OPDAT-it, nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, në vitin 2018 ka realizuar vizitë studimore në Institucionet më të larta të drejtësisë së Amerikës, përfshirë edhe Byronë e Statistikave në Amerikë. Drejtori i byrosë i ka dhënë një porosi delegacionit të KPK-së, që për interes të Republikës së Kosovës të adaptojnë Kategorizimin dhe Klasifikimin e vepra penale sipas kategorizimit të Amerikës, të cilin e ka përvetësuar edhe OKB-ja. Pjesëmarrësit e takimit ishte zotuar se do të bëjnë kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale sipas modelit të OKB-së (të marrë nga Byroja e Statistikave të Amerikës). Dokumenti i OKB-së mbi kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale që përcakton 11 grupe të veprave penale. Dokumenti i OKB-së është siguruar dhe përkthyer pjesërisht me vetiniciativë të Koordinatorit të KPK-së. Adaptimi i veprave penale të KPP-së me këtë mekanizëm do t’i shërbejë Republikës së Kosovës në rrugëtimin drejt antarësimit në OKB. Nëse KPK-ja vendos për të marrë modelin e OKB-së, atëherë përmes modifikimit në SMIL, mund të gjenerohet raportimi i veprave penale sipas 11 kategorizimeve të OKB-së.

Për më tej, Republika e Kosovës në kontekst të synimit për antarësim në OKB, duhet të bëjë kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale sipas modelit të OKB-së. Ky klasifikim mund të bëhet nga grupi punues dhe do të jetë një detyrë e kryer në kuadër të kriterëve të OKB-së.

Procedura:

Këshilli me vendim emëron grupin punues për hartimin e 1) Planit strategjik për profilizimin e prokurorëve, 2) Kategorizimit dhe klasifikimit të veprave penale të Kodit Penale dhe 2. Rregullores për profilizimin e prokurorëve të prokurorive themelore, në këtë përbërje:

- 1 anëtar prokurori i KPK-së,
- 1 koordinatori i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional,
- 2 kryeprokurorë të prokurorive të shkallës së parë,
- 2 prokurorë të DKR-së, të prokurorive të shkallës së parë
- 2 prokurorëve të DM-së, të prokurorive të shkallës së parë
- 2 prokurorëve të DP-së, të prokurorive të shkallës së parë.
- 1 shefi i zyrës së statistikave në NJSHP,
- 1 udhëheqësi i Departamentit të Teknologjisë Informative.
- 2 staf mbështetës, për grupin punues.

Planifikimi:**I. Hartimi i planit strategjik të profilizimit të prokurorëve**

1. Grupi punues harton dokumentin e kategorizimit dhe klasifikimit e veprave penale të Kodit Penal i Kosovës, me ndarje sipas vepres penale, nivelit të dënimit dhe kompetencës së departamenteve (*për ndihmesë është dokumenti 1 në shtojcë*).
2. Dokumenti i UNDOC-ut, për kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale sipas OKB-së, i përkthyer pjesërisht nga autori raportit, dërgohet për përkthim komplet. Grupi punues në bazë të dokumentit të përkthyer bën kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale të Kodit Penal sipas kategorizimit dhe klasifikimit të veprave penale të OKB-së (*në ndihmesë është dokumenti i përkthyer i OKB-së në shtojcën nr.2 të këtij raporti*).
3. Grupi punues bën analizën statistikore lidhur me kallëzimet penale të pranuar përgjatë 10 viteve (2013-2022), për secilin prej veprave penale mbi të cilën nxjerrë mesataren vjetore të pranimit të secilës vepër penale. Më tutje, në bazë të mesatares vjetore bëhet parashikimi 10 vjeçar i parashtrimit të kallëzimeve penale për veprat penale. Për më tej, mbi këto të dhëna bëhet planifikimi i nevojshëm i numrit të prokurorëve për secilin prej departamenteve të prokurorive themelore.
4. Grupi punues bën kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale, sipas pikës 1 duke krijuar për secilin departament të prokurorive themelore kategorizimin dhe klasifikimin e veprave penale sipas profilizimit tematik dhe shkallshmërisë së përqindjes së normës. Për më tej, cakton profilet e prokurorëve, individualisht (*në ndihmesë janë shembujt e ofruar në shtojcën nr.3 të këtij raporti, të ndarë për PTh.Prishtinë dhe për prokuroritë tjera, duke përfshirë mundësinë që të bëhet edhe profilizimi i prokurorëve në PSRK*).

II.Hartimi i Rregullores për profilizimit të prokurorëve të prokurorive themelore

1. Pas miratimit të planit strategjik Këshilli obligon grupin e njëjtë punues të hartojë rregulloren për profilizimin e prokurorëve të prokurorive themelore me mundësi edhe të profilizimit të prokurorëve në PSRK.
2. Grupi punues pas hartimit të Rregullores e procedon në Komisionin për Çështje normative, për shqyrtim të harmonizimit normative me legjislacionin në fuqi.
3. Këshilli, pas miratimit të Rregullores me vendim përcakton profilizimin e secilit prokuror në departamentet e prokurorive themelore, duke përcaktuar edhe periudhën kohore (shembull 3 apo 5 vjeçare), të trajtimit të lëndëve sipas profilit.
4. Këshilli dhe grupi punues duhet të analizojnë edhe aspektin e bashkëpunësorëve në raport me profilizimin e prokurorëve.

5.3 SHTOJCAT

1. Dokument punues për kategorizimi dhe klasifikimi i veprave penale të Kodit Penal, sipas nivelit të dënimit.
2. Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave penale sipas OKB-së.
3. Profilizimi tematik i shkallëzuar për PTh.Prishtinë,
 - i. Departamentet DKR, DP dhe DM (përveç Prishtinës),
 - ii. Profilizimi i një prokurori, konkretisht.
4. Profilizimi tematik i shkallëzuar për prokuroritë tjera themelore.
 - i. Departamentet DKR, DP dhe DM (përveç Prishtinës),
 - ii. Profilizimi i një prokurori, konkretisht.

Vërejtje: Me këtë metodologji mund të profilizohen edhe prokurorët në PSRK.

1. Dokument punues për kategorizimi dhe klasifikimi i veprave penale të Kodit Penal, sipas nivelit të dënimit.

Veprat penale të Kodit Penal, sipas kapitujve

Kapitulli	Emërtimi i kapitullit
XIV	Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës
XV	Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare
XVI	Veprat penale kundër jetës dhe trupit
XVII	Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut
XVIII	Veprat penale kundër të drejtave të votimit
XIX	Veprat penale kundër të drejtave të marrëdhënies në punë
XX	Veprat penale kundër integritetit seksual
XXI	Veprat penale kundër martesës dhe familjes
XXII	Veprat penale kundër shëndetit publik
XXIII	Veprat penale të narkotikëve
XXIV	Krimi organizuar (PSRK)
XXV	Veprat penale kundër ekonomisë
XXVI	Veprat penale kundër pasurisë
XXVII	Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore
XXVIII	Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë
XXIX	Veprat penale të Armëve
XXX	Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik
XXXI	Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike
XXXII	Veprat penale kundër rendit publik
XXXIII	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare

Tabela në vijim do të shërbejë për procesin e analizës dhe parashikimit, sipas pikës nr.1 të rekomandimit nr.5, për çdo departament të prokurorive themelore. Ndërsa kriteret dhe metodologjia e planifikimit të kuadrit prokurorial janë të përcaktuara në dokumentin e CEPEJ (linku në fusnotë) në gjuhën shqipe.

Kapitujt e Kodit Penal	Për Departamentet DKR, DM dhe DP të Prokurorive Themelore				
	Kallëzime penale të pranura dhe proceduara gjatë viteve 2013-2022	Mesatarja vjetore e kallëzimeve penale të pranura dhe të proceduara 2013-2022	Parashikimi i pranimit dhe procedimit të kallëzimeve penale për 10 vite 2023-2032	Mesatarja e parashikuar e pranimit dhe procedimit 2023-2032	Numri i nevojshëm i prokurorëve në DKR,DP,DM sipas metodologjisë së CEPEJ ³⁶ për 10 vite 2023-2032
XIV					
XXXIII					

Tabela në vazhdim është dokument punues për grupin punues, të kolonat e të cilit vendosen sanksionet sipas paragrafeve të nenit konkret dhe sanksionet që përcaktohen në nenet tjera lidhur me nenin konkret. Si shembull në dokument janë shkruar sanksionet për nenet 114 deri 127. Në bazë të këtij dokumenti, të përfunduar, bëhet ndarja sipas departamenteve DKR, DM dhe DP, respektivisht për secilin departament bëhet dokument i veçantë me veprat penale sipas kompetencës së departamentit.

³⁶ <https://rm.coe.int/published-nov-2018-udhezime-per-harten-gjyqesore/16809ebf11>

KODI NR. 06/L-074- PENAL (tabela është vetëm si shembull metodologjik, sepse sipas kodit janë mbi 45 lloje te dënimit ndërsa në tabelë janë 18 lloje te dënimit)

SANKSIONET																			
Neni	Tentativa	6 muaj deri 5 vjet	Deri 3 vjet	Jo më pak se 3 vjet	1-5 vjet	3-5 vjet	Deri 5 vjet	mbi 5 vjet	Jo më pak se 5 vjet	1-8 vjet	3-10 vjet	5-10 vjet	5-12 vjet	5-15 vjet	Jo më pak se 10 vjet	Së paku 10 vjet	10 - 20 vjet	Së paku 10 vjet deri me burgim të përjetshëm	Së paku 15 vjet deri me burgim të përjetshëm
114									Par.1,2						Par.3				
115									Par.1						Par.2				
116																Neni			
117																			Par.1, 2 & 3
118									Neni										
119																		Neni	
120									Neni										
121											Neni								
122				Neni															
123				Neni															
124									Par.3		Par.4	Par.1			Par.2,5			Par.6	
125	Dënohet sipas Ligjit Nr.03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690																		
126																			
127			Par.3		Par.2	Nenet 114-127			Anëtari grupit ë lajmëron grupin para kryerjes së veprës mund të lirohet nga dënimi										
128	Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit në nenet 114-139																		
129									Par.1						Par.2			Par.3	
130		Par.1									2, 3								
131														P.1					
132														Nen					
133														P.1					
134					Nen														
135		Par.2									.1, 3								
136												Par.2					P.1		
137										Par.2	Par.1								
138																			
139																			
140																			
141	4																		
430																			

5. Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave penale sipas OKB-së.

Njëmbëdhjetë (11) kategoritë e veprave penale sipas OKB-së.

Grupi	Emërtimi i grupeve të veprave penale sipas katalogut të OKB-së
1	Veprat që shkaktojnë vdekje ose që synojnë të shkaktojnë vdekjen
2	Veprat që shkaktojnë apo synojnë t'i shkaktojnë personit dëmtime
3	Aktet dëmtuese të natyrës seksuale
4	Veprat kundër pronës që përfshijnë dhunë ose kërcënim ndaj një personi
5	Veprat vetëm kundër pasurisë
6	Veprat që përfshijnë substanca psiko-aktive të kontrolluara ose droga të tjera
7	Veprat që përfshijnë mashtrimin, dinakërinë ose korrupsionin
8	Veprat kundër rendit publik, autoritetit dhe dispozitave shtetërore
9	Veprat kundër sigurisë publike dhe sigurisë shtetërore
10	Vepron kundër mjedisit natyror
11	Vepra të tjera kriminale që nuk klasifikohen diku tjetër

1.VEPRAT QË SHKAKTOJNË VDEKJE OSE SYNOJNË TË SHKAKTOJNË VDEKJE			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
101			Vrasje me dashje
102			Vrasje me dashje në tentativë
103			Vrasje e paqëllimshme
	1031		Vrasje nga mos-pakujdesia
	1032		Vrasje nga pakujdesia
		10321	Vrasje me makinë
		10322	Vrasje pa makinë
104			Ndihma ose nxitja në vetëvrasje
	1041		Ndihma në vetëvrasje
	1042		Akte të tjera që shkaktojnë vdekje nga vetëvrasja
105			Vdekje e vullnetshme (eutanzia)
106			Vrasje e paligjshme e fetusit
107			Vrasje të paligjshme që lidhen me konfliktin e armatosur
108			Veprat tjera që shkaktojnë vdekje
2.VEPRAT QË SHKAKTOJNË APO SYNOJNË TË SHKAKTOJNË DËMTIME PERSONIT			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
201			Sulmet dhe kërcënimet
	2011		Sulmi
		20111	Sulmi i rëndë
		20112	Sulmi i lehtë
	2012		Kërcënimi
		20121	Kërcënimi i rëndë

		20122	Kërcënimi i lehtë
	2013		Veprat tjera që shkaktojnë kërcënime për lëndim ose dëmtim
202			Veprat kundër lirisë
	2021		Rrëmbimi i të miturit
		20211	Rrëmbimi prindëror
		20212	Rrëmbimi nga një anëtar i familjes
		20213	Rrëmbimi nga një kujdestar ligjor
		20214	Rrëmbime të tjera të të miturit
	2022		Privimi i lirisë
		20221	Rrëmbim
		20222	Kufizimi i paligjshëm
		20223	Plaçkitja
		20224	Privimet tjera të lirisë
	2023		Veprat tjera kundër lirisë
		20231	Birësimi i paligjshëm
		20232	Martesa e detyruar
		20233	Veprat tjera kundër lirisë
203			Skllavëria dhe shfrytëzimi
	2031		Skllavëria
	2032		Punë e detyruar
		20321	Punë e detyruar për shërbime shtëpiake
		20322	Punë e detyruar për shërbimet e industrisë
		20323	Punë e detyruar për shtetin ose forcat e armatosura
		20324	Punë të tjera të detyruara
	2033		Veprat tjera të skllavërisë dhe punës së detyruar
204			Trafikimi me persona
	2041		TIP për shfrytëzim seksual
	2042		TIP për punë ose shërbime të detyruara
	2043		TIP për heqjen e organeve
	2044		TIP për qëllime të tjera
205			Shtrëngimi
	2051		Zhvatje ose shantazh
	2051		Vepra të tjera të shtrëngimit
206			Vepra nga pakujdesia
	2061		Pakujdesia në situata me persona nën përkujdesje
		20611	Pakujdesia në situata me fëmijë nën përkujdesje
		20612	Pakujdesia në situata të personave të tjerë të varur nga përkujdesja
		20613	Pakujdesitë tjera në situatat e personave nën përkujdesje
	2062		Pakujdesia profesionale
	2063		Pakujdesia lidhur me ngacjen e automjetit
	2064		Vepra tjera nga pakujdesia

207			Aktete rrezikshme
	2071		Aktetqë rrezikojnë shëndetin
	2072		Ngasja e automjetit nën ndikimin e substancave psikoaktive
		20721	Ngasja e automjetit nën ndikimin e alkoolit
		20722	Ngasja e automjetit nën ndikimin e drogave
		20723	Ngasja e automjetit nën ndikimin e substancave psikoaktive
	2073		Veprime tjera të rrezikshme që shkaktojnë lëndime
208			Veprime që synojnë të nxisin frikë ose shqetësim emocional
	2081		Ngacmimi
		20811	Ngacmimi në vendin e punës
		20812	Ngacmime të tjera
	2082		Përndjekje
	2083		Veprime që synojnë të nxisin frikë ose shqetësim emocional
209			Shpifje ose fyerje
	2091		Shpifje ose fyerje për shkak të karakteristikave të viktimës ose tipareve të përshkruara
	2092		Shpifje ose fyerje për shkak të besimeve apo vlerave të përshkruara nga viktimat
	2093		Shpifje apo fyerje tjetër
210			Diskriminimi
	2101		Diskriminimi personal
	2102		Diskriminimi grupor
	2103		Diskriminimet tjera
211			Veprat e palejuara kundër personit
	2111		Pushtimi i privatësisë
	2112		Aktet tjera të palejuara kundër personit
212			Akte tjera që shkaktojnë dëmtime ose synojnë t'i shkaktojnë personit dëmtime
3. AKTET DËMTUESE TË NATYRËS SEKSUALE			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
301			Dhuna seksuale
	3011		Përdhunimi
		30111	Përdhunimi me forcë
		30112	Përdhunimi pa forcë
		30113	Përdhunimi sipas ligjit
		30114	Përdhunimet tjera
	3012		Sulmi seksual
		30121	Sulmi fizik seksual
		30122	Sulmi jo-fizik seksual
		30123	Sulme të tjera seksuale që nuk përbëjnë përdhunim
	3013		Veprime të tjera të dhunës seksuale
302			Shfrytëzimi seksual
	3021		Shfrytëzimi seksual i të rriturve
	3022		Shfrytëzimi seksual i fëmijëve

		30221	Pornografia me fëmijë
		30222	Prostitucioni me fëmijë
		30223	Shfrytëzimi seksual i fëmijëve
		30224	Shfrytëzimet tjera seksuale të fëmijëve
	3023		Aktetjetera të shfrytëzimit seksual
304			Aktetjetera dëmtuese të natyrës seksuale
4.VEPRAT KUNDËR PRONËS QË PËRFSHINË DHUNË OSE KËRCENIM NDAJ NJË PERSONI			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
401			Grabitja
	4011		Grabitja nga personi
		40111	Grabitja nga personi në një vend publik
		40112	Grabitja nga personi në një lokacion privat
		40113	Grabitje të tjera nga personi
	4012		Grabitja e sendeve me vlerë ose mallrave në transit
		40121	Grabitja e një makine ose automjeti
		40122	Grabitje të tjera me vlerë ose mallra në transit
	4013		Grabitja e një institucioni ose institucioni
		40131	Grabitje e një institucioni financiar
		40132	Grabitja e një institucioni jofinanciar
	4014		Grabitja e një gjëje të gjallë
	4015		Veprime të tjera të grabitjes
402			Veprime të tjera kundër pronës që përfshijnë dhunën ndaj një personi
5.VEPRAT KUNDËR PASURISË			
Div	Grupi	Klass	Krimi
501			Vjedhje me thyerje
	5011		Vjedhje me thyerje të lokaleve afariste
	5012		Vjedhje me thyerje të lokaleve rezidenciale/private
	5013		Vjedhje me thyerje të lokaleve publike
	5014		Aktetjetera të vjedhjeve me thyerje
502			Vjedhje
	5021		Vjedhja e një automjeti të motorizuar të pjesëve të tij
		50211	Vjedhja e një automjeti të motorizuar tokësor
		50212	Përdorimi i paligjshëm i një automjeti të motorizuar
		50213	Vjedhja e pjesëve të një automjeti të motorizuar tokësor
		50214	Vjedhje të tjera të një automjeti të motorizuar ose pjesëve të tyre
	5022		Vjedhja e pronës personale
		50221	Vjedhja e pasurisë personale nga një person
		50222	Vjedhja e pronës personale nga një automjet
		50223	Vjedhje të tjera të pronës personale

	5023		Vjedhja e pronës së biznesit
		50231	Vjedhja nga një dyqan
		50232	Vjedhje nga një lloj tjetër lokalesh afariste
	5024		Vjedhja e pronës publike
	5025		Vjedhja e bagëtisë
	5026		Vjedhja e shërbimeve
	5027		Vjedhjet tjera
503			Vjedhja e pronësisë intelektuale
504			Dëmtimi i pronës
	5041		Dëmtimi i pronës publike
	5042		Dëmtimi i pronës personale
	5043		Dëmtimi i pronës së biznesit
	5044		Dëme të tjera të pronës
504			Aktet tjera vetëm kundër pronës
6.VEPRAT QË PËRFSHIJNË SUBSTANCA PSIKOAKTIVE TË KONTROLLUARA OSE DROGA TJERA			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
601			Veprime të paligjshme që përfshijnë droga të kontrolluara ose pararendëse (prekursorë)
	6011		Posedim ose përdorim i paligjshëm i drogave të kontrolluara për konsum personal
	6012		Kultivimi i paligjshëm ose prodhimi i drogave të kontrolluara
	6013		Trafikimi i paligjshëm ose shpërndarja e drogave të kontrolluara
		60131	Shitja e nivelit rrugor të sasive të vogla të drogave të kontrolluara
		60132	Tregti me shumicë me drogë
		60133	Trafikimi tjetër ose shpërndarja e drogave të kontrolluara
	6014		Aktet tjera të paligjshme që përfshijnë droga të kontrolluara, substanca psikoaktive ose prekursorë
602			Veprime të paligjshme që përfshijnë alkool, duhan ose substanca të tjera të kontrolluara
	6021		Prodhimi, trajtimi, posedimi apo përdorimi i paligjshëm i produkteve alkoolike
		60211	Posedimi ose përdorimi i paligjshëm i produkteve alkoolike
		60212	Prodhimi i paligjshëm, trafikimi ose shpërndarja e produkteve alkoolike
		60213	Trajtimi dhe posedimi i paligjshëm ose përdorimi i produkteve të alkoolit
	6022		Trajtimi dhe posedimi i paligjshëm ose përdorimi i produkteve të duhanit
		60221	Posedimi ose përdorimi i paligjshëm i produkteve të duhanit
		60222	Prodhimi, trafikimi ose shpërndarja e paligjshme ose produktet e duhanit
		60223	Trajtimet, posedimet apo përdorimet tjera të paligjshme të produkteve të duhanit
	6023		Veprime të tjera të paligjshme që përfshijnë alkool, duhan ose substanca të tjera të kontrolluara
603			Veprime tjera që përfshijnë substanca psikoaktive të kontrolluara
7.VEPRAT QË PËRFSHIJNË MASHTRIMIN, DINAKËRINE OSE KORRUPSIONIT			

Div	Grupi	Klasa	Krimi
701			Mashtrimi
	7011		Mashtrimi financiar
		70111	Mashtrimi financiar kundër shtetit
		70112	Mashtrimi financiar kundër personit fizik apo juridik
	7012		Aktet tjera të mashtrimit
702			Falsifikimi/imitimi
	7021		Falsifikimi i mjeteve të pagesës
		70211	Falsifikimi i mjeteve për pagesë në dorë
		70212	Falsifikimi i mjeteve të pagesave jo në dorë
	7022		Veprat e falsifikimit të produkteve
	7023		Veprat e imitimit/falsifikimit të dokumenteve
	7024		Veprat tjera të imitimit/falsifikimit
703			Korrupsioni
	7031		Ryshfeti
		70311	Ryshfeti aktiv
		70312	Ryshfeti pasiv
	7032		Përvetësimi
	7033		Keqpërdorimi i funksionit
	7034		Tregti nën ndikim
	7035		Pasurimi i paligjshëm
	7036		Aktet tjera të korrupsionit
704			Veprat që përfshijnë të ardhurat nga krimi
	7041		Shpërlarja e parasë
	7042		Trafikimi i paligjshëm i pronës kulturore
	7043		Aktet tjera që përfshijnë të ardhurat nga krimi
8.VEPRAT KUNDËR RENDIT PUBLIK, AUTORITETIT DHE DISPOZITAVE SHTETËRORE			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
801			Veprat kundër standardit të sjelles së rendit publik
	8011		Veprat e dhunshme të trazirave publike
	8012		Aktet që lidhen me normat dhe standardet shoqërore dhe religjioze të rendit publik
	8013		Aktet tjera kundër standardeve të sjelles të rendit publik
802			Aktet kundër standardeve seksuale të rendit publik
	8021		Veprat e prostitucionit
	8022		Veprat e pornografisë
	8023		Aktet tjera kundër standardeve seksuale të rendit publik
803			Aktet që lidhen me lirinë ose kontrollin e shprehjes
	8031		Aktet kundër lirisë së shprehjes
	8032		Aktet që lidhen me shprehjen e besimeve dhe normave të kontrolluara sociale
		80321	Shkeljet e normave mbi besimet fetare / pikëpamjet

		80322	Shkeljet e normave mbi intolerancën dhe nxitjen ndaj urrejtjes
		80323	Aktet tjera që lidhen me shprehjet e besimeve dhe normave të kontrolluara sociale
804			Aktet kundërshtim me të burimet publike ose dispozitat rregullatore
	8041		Aktet kundër dispozitave të burimeve publike
	8042		Aktet kundër rregullave tregtare ose financiare
	8043		Aktet kundër rregullave mbi bastin
	8044		Kontrabandimi i mallrave
	8045		Manipulimet e tregut ose tregtia e brendshme
	8046		Aktet tjera kundër administratës publike ose dispozitave rregullatore
805			Aktet që lidhen me migracionin
	8051		Veprat e kontrabandimit me migrant
	8052		Veprat tjera të paligjshme që lidhen me migracionin
806			Aktet kundër sistemit të drejtësisë
	8061		Pengimi i drejtësisë
	8062		Prishja e rendit juridik
	8063		Qëllimi kriminal
	8064		Komploti
	8065		Aktet tjera kundër sistemit të drejtësisë
807			Aktet që lidhen me zgjedhjet demokratike
	8071		Aktet që synojnë të ndikojnë padrejtësisht në votuesit në zgjedhje
	8072		Aktet e tjera që lidhen me zgjedhjet demokratike
808			Vepra në kundërshtim me ligjin e punës
	8081		Shkeljet kolektive të ligjit të punës
	8082		Shkeljet individuale të ligjit të punës
809			Aktet tjera kundër rendit public, autoritetit dhe dispozitave të shtetit
9. VEPRAT KUNDER SIGURISË PUBLIKE DHE SIGURISË SHETETËRORE			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
901			Aktet që përfshijnë, armë, eksplozivë dhe material të tjera shkatërruese
	9011		Posedimi ose përdorimi i armëve dhe eksplozivëve
		90111	Posedim ose përdorim i paligjshëm i armëve të zjarrit
		90112	Posedim ose përdorim i paligjshëm i armëve ose eksplozivëve të tjerë
		90113	Posedim ose përdorim i paligjshëm i materialeve kimike, biologjike ose radioaktive
		90114	Aktet e tjera që lidhen me posedimin ose përdorimin e armëve dhe eksplozivëve
	9012		Trafikimi i armëve dhe eksplozivëve
		90121	Trafikimi i armëve të zjarrit
		90122	Trafikimi i armëve ose eksplozivëve të tjerë
		90123	Trafikimi i materialeve kimike, biologjike ose radioaktive
		90124	Akte të tjera që lidhen me trafikimin e armëve dhe eksplozivëve
	9013		Aktet e tjera që lidhen me armët dhe eksplozivët
902			Aktet kundër shëndetit dhe sigurisë
	9021		Aktet kundër shëndetit dhe sigurisë në punë

	9022		Akte të tjera kundër shëndetit dhe sigurisë
903			Aktet kundër sistemeve kompjuterike
	9031		Qasje e paligjshme në një sistem kompjuterik
	9032		Ndërhyrja e paligjshme me një sistem kompjuterik apo të dhëna kompjuterike
		90321	Ndërhyrje të paligjshme në një sistem kompjuterik
		90322	Ndërhyrje të paligjshme me të dhënat kompjuterike
	9033		Përgjimi i paligjshëm ose qasja në të dhënat kompjuterike
	9034		Aktet tjera kundër sistemeve kompjuterike
904			Aktet kundër sigurisë shtetërore
905			Aktet e lidhura me grupet e organizuara kriminale
	9051		Pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar
	9052		Aktet e tjera që lidhen me një grup kriminal të organizuar
906			Terrorizmi
	9061		Pjesëmarrja në një grup terrorist
	9062		Financimi i terrorizmit
	9063		Akte të tjera që lidhen me aktivitetet e një grupi terrorist
907			Shkeljet në trafik pa dëmtime
908			Aktet tjera kundër rendit publik dhe sigurisë shtetërore
10.VEPRAT KUNDËR MJEDISIT NATYRAL			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
1001			Veprat që shkaktojnë ndotje ose degradim të mjedisit
	10011		Veprat që shkaktojnë ndotjen ose degradimin e ajrit
	10012		Veprat që shkaktojnë ndotjen ose degradimin e ujit
	10013		Veprat që shkaktojnë ndotjen ose degradimin e tokës
	10014		Akte të tjera që shkaktojnë ndotjen ose degradimin e mjedisit
1002			Veprat që përfshijnë lëvizjen ose hedhjen e mbeturinave
	10021		Veprat që përfshijnë lëvizjen ose hedhjen e mbeturinave brenda kufijve kombëtarë
	10022		Veprat që përfshijnë lëvizjen ose hedhjen e mbeturinave përtej kufijve kombëtarë
1003			Tregtimi ose posedimi i llojeve të mbrojtura ose të ndaluara të faunës dhe florës
	10031		Tregtimi ose posedimi i llojeve të mbrojtura të faunës dhe florës së egër
		100311	Tregtimi ose posedimi i specieve të mbrojtura brenda kufirit kombëtar
		100312	Trafikimi i llojeve të mbrojtura përtej kufijve kombëtarë
	10032		Tregtimi ose posedimi i llojeve të ndaluara ose të kontrolluara të kafshëve
1004			Veprat që rezultojnë në shterimin ose degradimin e burimeve natyrore
	10041		Kycja e paligjshme
	10042		Gjuetia paligjshme, peshkimi ose mbledhja e faunës dhe florës së egër
	10043		Shfrytëzimi paligjshme minierave
	10044		Akte të tjera që rezultojnë në shterimin e burimeve natyrore
1005			Veprat tjera kundër mjedisit natyror
	10051		Veprat kundër kafshëve

	10052		Veprat të tjera kundër mjedisit natyror
11.VEPRAT TJERA KRIMINALE QË NUK KLASIFIKOHEN DIKU TJETËR			
Div	Grupi	Klasa	Krimi
1101			Veprat nën juridiksionin universal
	11011		Tortura
	11012		Pirateria
	11013		Krimet e luftës
		110131	Vrasje të paligjshme, duke shkaktuar ose duke synuar të shkaktojnë vdekje ose lëndime serioze të lidhura me konflikte të armatosura
		110132	Shkatërrimi ose dëmtimi i paligjshëm i pronës që lidhet me konfliktin e armatosur
		110133	Dhuna seksuale e lidhur me konfliktet e armatosura
		110134	Veprat kundër lirisë ose dinjitetit njerëzor të lidhura me konflikte të armatosura
		110135	Rekrutimi ose regjistrimi i ushtarëve fëmijë
	11014		Gjenocidi
	11015		Krime kundër njerëzimit
	11016		Krimi i agresionit
	11017		Aktet tjera nën juridiksionin universal
1102			Veprat në kundërshtim me rregulloret për të rinj dhe veprat ndaj të miturve
	11021		Shkeljet e statusit
	11022		Veprat tjera në kundërshtim me rregulloret për të rinj dhe veprat ndaj të miturve
1103			Vepra të tjera kriminale që nuk klasifikohen diku tjetër

1. PROFILIZIMI TEMATIK I SHKALLËZUAR PËR PTH.PRISHTINË

Shembull: Profilët e prokurorëve në DKR, sipas kategorizimi/klasifikimit të Kodi Penal

Profili	Kapitulli	DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA	Norma
Prokurori 1	XXXIII	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	50%
	XXV	Veprat penale kundër ekonomisë	30%
	XXXI	Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	20%
Prokurori 2	XVI	Veprat penale kundër jetës dhe trupit	50%
	XXI	Veprat penale kundër martesës dhe familjes	30%
	XXIX	Veprat penale të Armëve	20%
Prokurori 3	XXIII	Veprat penale të narkotikëve	50%
	XXII	Veprat penale kundër shëndetit publik	30%
	XXIX	Veprat penale të Armëve	20%
Prokurori 4	?	?	50%
	?	?	30%
	?	?	20%
Prokurori 5	?	?	50%
	?	?	30%
	?	?	20%
Prokurori 6	XXV	Veprat penale kundër ekonomisë	50%
	XXXIII	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	30%
	XXXI	Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike	20%

Shembull: Profilët e prokurorëve në DKR, sipas kategorizimit dhe klasifikimit të OKB-së

Profili	Grupi	DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA	Norma
Prokurori 1	7	Veprat që përfshijnë mashtrimin, dinakërinë ose korrupsionin	50%
	5	Veprat vetëm kundër pasurisë	30%
	10	Veprat kundër mjedisit natyror	20%
Prokurori 2	1	Veprat që shkaktojnë vdekje ose që synojnë të shkaktojnë vdekjen	50%
	2	Veprat që shkaktojnë apo synojnë t'i shkaktojnë personit dëmtime	30%
	4	Veprat kundër pronës që përfshijnë dhunë ose kërcënim ndaj një personi	20%
Prokurori 3	8	Veprat kundër rendit publik, autoritetit dhe dispozitave shtetërore	50%
	9	Veprat kundër sigurisë publike dhe sigurisë shtetërore	30%
	11	Vepra të tjera kriminale që nuk klasifikohen diku tjetër	20%
Prokurori 4	3	Aktet dëmtuese të natyrës seksuale	50%
	4	Veprat kundër pronës që përfshijnë dhunë ose kërcënim ndaj një personi	30%
	6	Veprat që përfshijnë substanca psiko-aktive të kontrolluara ose droga të tjera	20%
Prokurori 5	?	?	50%
	?	?	30%
	?	?	20%
Prokurori 6	5	Veprat vetëm kundër pasurisë	50%
	7	Veprat që përfshijnë mashtrimin, dinakërinë ose korrupsionin	30%
	10	Veprat kundër mjedisit natyror	20%

Një prokuror me vendim të Këshillit profilizohet për një periudhë kohore 3-5 vjet, sipas dy alternative: 1) Sipas kapitujve të Kodit Penal, 2) Sipas grupeve të OKB-së,

E njëjta metodologji mund të përdoret për profilizimin e prokurorëve në PSRK, duke shtuar edhe veprat penale me kompetencë ekskluzive të PSRK-së.

2. PROFILIZIMI TEMATIK I SHKALLËZUAR PËR PROKURORITË TJERA THEMELORE

Shembull: Profilët e prokurorëve DKR, sipas kategorizimit të grupit punues, Kodit Penal

Profili	Kapitulli	DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA	Norma
Prokurori 1	XXXIII	Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	35%
	XXV	Veprat penale kundër ekonomisë	25%
	XXVI	Veprat penale kundër pasurisë	20%
	XVII	Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	15%
	XXVIII	Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	5%
Prokurori 2	XVI	Veprat penale kundër jetës dhe trupit	35%
	XXI	Veprat penale kundër martesës dhe familjes	25%
	XX	Veprat penale kundër integritetit seksual	20%
	XXIX	Veprat penale të Armëve	15%
	XXVIII	Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	5%
Prokurori 3	XXIII	Veprat penale të narkotikëve	35%
	XXII	Veprat penale kundër shëndetit publik	25%
	XXIX	Veprat penale të Armëve	20%
	XX	Veprat penale kundër integritetit seksual	15%
	XXI	Veprat penale kundër martesës dhe familjes	5%
Prokurori 4	?	?	35%
	?	?	25%
	?	?	20%
			15%
			5%

Shembull: Profilët e prokurorëve në DKR, sipas kategorizimit dhe klasifikimit të OKB-së

Profili	Grupi	DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA	Norma
Prokurori 1	7	Veprat që përfshijnë mashtrimin, dinakërinë ose korrupsionin	40%
	5	Veprat vetëm kundër pasurisë	25%
	4	Veprat kundër pronës që përfshijnë dhunë ose kërcënim ndaj një personi	20%
	11	Vepra të tjera kriminale që nuk klasifikohen diku tjetër	15%
Prokurori 2	1	Veprat që shkaktojnë vdekje ose që synojnë të shkaktojnë vdekjen	35%
	2	Veprat që shkaktojnë apo synojnë t'i shkaktojnë personit dëmtime	25%
	4	Veprat kundër pronës që përfshijnë dhunë ose kërcënim ndaj një personi	20%
	6	Veprat që përfshijnë substanca psiko-aktive të kontrolluara ose droga tjera	15%
Prokurori 3	3	Aktet dëmtuese të natyrës seksuale	35%
	6	Veprat që përfshijnë substanca psiko-aktive të kontrolluara ose droga tjera	25%
	2	Veprat që shkaktojnë apo synojnë t'i shkaktojnë personit dëmtime	20%
	11	Vepra të tjera kriminale që nuk klasifikohen diku tjetër	15%
Prokurori 4	?	?	35%
	?	?	25%
	?	?	20%
	?	?	15%

Këshilli Prokurorial I Kosovës me vendim e profilizon prokurorin për një periudhë kohore 3-5 vjet, sipas dy alternative: 1) Sipas kapitujve të Kodit Penal të Kosovës apo 2) Sipas grupeve të OKB-së.